

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6004  
E mërkurë, 19 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

## Policja vret prindërit, dy vëllezërit, pastaj veten



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE",  
SHPEJTIM BULLIQI

# PODUJEVA NUK ËSHTË MË BASTION I LDK-SË



Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka shprehur optimizëm se më 15 mars do ta thyejë bastionin e LDK-së në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo komunë më nuk është bastion i asnjë partie politike. Ai ka treguar se diferenca e vogël e votave në zgjedhjet nacionale në mes të LDK-së dhe LV-së e bën optimist se do të triumfojë në këtë garë për kryetar komune. Teksa ka shpalosur ofertën për qytetarët e Komunës së Podujevës, Bulliqi ka deklaruar se programi i tij prek çdo fushë. Ai ka bërë me dije se ndër prioritetet kryesore të tij është depolitizimi i shërbyesve publikë

## OPINION

### ÇFARË SOLLI SAMITI I MUNIHUT NË MES TË KURTIT E RAMËS

F. 11

Bedri  
ISLAMI



## AKTUALE



### SHQIPËRIA MBLEDH 1.15 MILIARD EURO NGA KONFERENCA E DONATORËVE

F. 2

### THYHEN PËR TË DYTËN HERË ZYRAT E AGK-së

F. 6

### KLINIKA E SYVE OFRON MBËSHETJE PËR SPITALET E PËRGJITHSHME

F. 6

## EKONOMI

### MBI 148 MIJË VETURA TË PAREGJISTRUARA SFIDOJNË KARTONIN E GJELBËR

F. 9

### AUDITORI: LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË BËHET SIPAS HARRXHIMEVE REALE

F. 8

## KULTURË

### TERRORI SHTETËROR JUGOSLLAV NDAJ KRIJUESVE ISHTE I DHUNSHËM DHE BARBAR

F. 15

Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA

## Reciprociteti dhe taksa përplasnin partitë parlamentare

Deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë dhënë qëndrime të ndryshme sa i përket taksës 100 për qind dhe reciprocitetit me Serbinë. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka thënë se taksa e ka humbur efektin e saj dhe nuk po sjell efektet e dëshiruara. Arben

Gashi, shef i grupit parlamentar i LDK-së, ka theksuar se qeveria është duke e shqyrtuar heqjen e taksës dhe vendosjen e reciprocitetit. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Daut Haradinaj, është shprehur kundër heqjes së taksës pa njohjen e Kosovës nga Serbia



Shkruan:  
Enver  
HOXHAJ

## Gjeopolitika etnike e Putinit: Kosova, fushëbeteja e parë (2)

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Shqipëria mbledh 1.15 miliard euro nga Konferenca e Donatorëve

Tiranë, 18 shkurt - Në Konferencën e Donatorëve që është mbajtur në Bruksel, Shqipëria ka mbledhur 1.15 miliard dollarë ndihmë për t'u rikuperuar nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se donatorët ndërkombëtarë kanë ofruar 1.15 miliard euro për t'i ndih-

muar Shqipërisë, pas tërmetit që ka dëmtuar një pjesë të këtij vendi në nëntor të vitit të kaluar. "Lajm i mirë për popullin e Shqipërisë: Ne kemi tejkaluar shënjestrën tonë për rindërtim të Shqipërisë dhe kemi mbledhur 1.15 miliard euro", ka shkruar von der Leyen në një postim në "Twitter", pas konferencës së mbajtur të hënën

në Bruksel.

Ajo ka thënë se aty përfshihen edhe 400 milionë euro të kontributeve të Bashkimit Evropian. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se për Shqipërinë do të ishte sukses i madh sikur të arrinin deri në 50 për qind të shumës prej rreth 1 miliard eurove sa është dëmi total që shkaktoi tërmeti.



## Miliarderi Bloomberg kualifikohet për debatin e demokratëve

Një sondazh i ri e nxjerr Bloombergun të dytin me 19 % mbështetje, pas senatorit nga Vermonti, Bernie Sanders, i cili kryeson me 31 %, duke u kualifikuar për debatin e ardhshëm presidencial të demokratëve, hera e parë që ai do të marrë pjesë në garat e tyre për t'u përballur me presidentin Trump në zgjedhjet e nëntorit

WASHINGTON, 18 SHKURT - Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Michael Bloomberg, është kualifikuar për debatin e ardhshëm presidencial të demokratëve, hera e parë që ai do të marrë pjesë në garat e tyre për t'u përballur me presidentin Trump në zgjedhjet e nëntorit.

Një sondazh i ri, i publikuar të martën, e nxjerr Bloombergun të dytin me 19 % mbështetje, pas senatorit nga Vermonti, Bernie Sanders, i cili kryeson me 31 %. Paraqitja e mirë e Bloombergut e ndihmoi atë ta arrinte mbështetjen mesatare prej 10 % në të paktën katër sondazhe kombëtare, që është kusht i partisë demokrate për të marrë pjesë në debatin e së mërkurës në shtetin Nevada, ka njoftuar "voa". Megjithatë, Bloomberg i ka fokusuar përpjekjet në 14 shtetet që do të zhvillojnë zgjedhje paraprake më 3 mars.

Ish-nënpresidenti Joe Biden ishte i treti në sondazh me 15 % mbështetje, i pasuar nga senatorja nga Masaçusetsi, Elizabeth Warren me 12%, ajo nga Minesota Amy Klobuchar me 9 % dhe nga ish-kryebashkiaku i South Bendit, Pete Buttigieg, me 8 %.

Ndërsa Bloombergu është ngritur në sondazhe pas hyrjes në garë me vonesë. Ai është bërë objekt i goditjeve të ashpra nga rivalët demokratë si dhe presidenti Trump, i cili e talli atë javën e kaluar duke e quajtur një "masë të energjisë së vdekur" dhe "Mini Mike (Majku i vogël)" për shtatin e tij të shkurtër.

Nga ana tjetër, Bloomberg e quajti presidentin Trump "një kloun", duke shtuar: "Në anët tona ne e masim gjatësinë nga qafa e lartë".

Kundërshtarët demokratë e kanë akuzuar Bloombergun, i cili thuhet se ka një pasuri prej



62 miliardë dollarësh, se është përpjekur ta blejë emërimin e partisë.

Bloombergu raportohet se ka harxhuar gati 400 milionë dollarë nga paratë e tij për reklama fushate dhe ka punësuar qindra punonjës fushate përpara votimit të 3 marsit, që njihet si 'Super e Marta', kur ai do të jetë në votim.

Bloombergu e bëri pasurinë kur ishte themelues i kompanisë së informacionit të biznesit që mban emrin e tij dhe, gjithashtu, faqen e internetit "Bloomberg News".

Sanders, një demokrat i vetëshpallur socialist, ka sulmuar gjithnjë e më shumë Bloombergun, i cili ishte kryetar i bashkisë së Nju Jorkut nga viti 2002 deri në vitin 2013. "Kryebashkiaku Bloomberg, me të gjitha paratë e tij, nuk do ta krijojë llojin e entuziazmit dhe energjisë që na duhet dhe në pjesëmarrjen e votuesve që duhet të kemi për ta mposhtur Donald Trumpin", tha Sanders në një tubim.

Sanders sulmoi politikën "raciste" të Bloombergut për arrestimet pas "ndalimeve dhe

kontrolleve" të njerëzve në lagjet me krime të larta në lagjet e Nju Jorkut kur ishte kryetar bashkie, një politikë për të cilën Bloombergu ka kërkuar falje.

Një video-regjistrim i vitit 2015 u publikua javën e kaluar, ku Bloombergu thoshte se mënyra më e mirë për ta zvogëluar dhunën me armë të rinjtë e pakicave ishte t'i "hidhnin ata përpara një muri dhe t'i kontrollonin".

Bloombergu e pranoi gjatë fundjavës: "Kohët e fundit kam marrë shumë kritika për politikën 'ndalo dhe kontrollo', por unë e mbrojta atë shumë gjatë sepse nuk e kam kuptuar plotësisht dhimbjen që shkaktoi pa dashje te familjet e të rinjve afrikanë-amerikanë dhe ata të pakicave të tjera. Duhet të kisha vepruar më shpejt dhe ta kisha ndaluar atë. Por, nuk e bëra, dhe kërkova falje për këtë".

Bloombergu, gjithashtu, ka nxjerr një kontroll më të hollësishëm të historisë së tij nga media kryesore amerikane. Gjatë fundjavës gazeta "The Washington Post" publikoi një histori të gjatë për komentet seksiste të Bloombergut, që kishin në shënjestër gratë që punonin në kompaninë e tij të shërbimeve financiare.

## Rrezikohet mbajtja e zgjedhjeve në Podujevë shkaku i buxhetit

PRISHTINË, 18 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije e nuk është miratuar buxheti për mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Podujevës dhe se mosaprovimi i këtij buxheti rrezikon mbajtjen e këtyre zgjedhjeve.

Kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, Yll Buleshkaj, tha se këtë informacion e mori me vonesë, pra gjatë mbajtjes së mbledhjes së KQZ-së.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, tha se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer të gjitha procedurat me kohë dhe, sipas saj, pa buxhet nuk mund t'i vazhdojnë procedurat e tjera të zgjedhjeve. "Ne jemi 25 ditë larg nga dita e zgjedhjeve dhe nuk na ka ndodhur të mos kemi fletëvotime. Janë shtypur jashtë Kosovës, por janë procedurat e prokurimit. Që nga dita e sotme nuk mund ta bartim përgjegjësinë dhe ditën e zgjedhjeve mund të na ndodhë të mos

kemi fletëvotime. Dhe duhet të na referohen vërejtjet në buxhet", ka thënë ajo.

Mosmiratimi i buxhetit për zgjedhjet e kryetarit të Komunës së Podujevës u bë i ditur 25 ditë para ditës së votimit. Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës janë planifikuar të mbahen më 15 mars. Në garë për kryetar janë tre kandidatë: Nexhmi Rudari nga LDK-ja, Shpejtim Bulliqi nga LV-ja dhe Naim Fetahu nga PDK-ja.





# Gjeopolitika etnike e Putinit: Kosova, fushëbeteja e parë (2)

**Shkruan:**  
**Enver HOXHJA**

Në gushtin e 1999 Boris Jeltsini do ta befasojë botën me vendimin për ta emëruar Putinin kryeministër të Rusisë. Shumë pak dihej ndërkombëtarisht se kush ishte ai në të vërtetë. Gjatë kësaj punuar pas perdeve dhe me poste jo të larta. Në fund të viteve '80 shërbeu në stacionin e KGB-së në Drezden, me një detyrë interesante: puna e tij nuk ishte spiunazhi, por kundërspiunazhi. Do të thoshte, identifikimi, mundja (defeating) dhe shkatërrimi i armiqve sovjetikë. Në fillim të '90-s, kur Mikhail Gorbachev u zotua për ta modernizuar dhe hapur Bashkimin Sovjetik, deri atëherë të mbyllur e komunist, Putini u bë i njohur brenda shërbimit të KGB me këtë fjali. "Çfarë po bënte Gorbaçov ishte konspiracion për ta shitur atdheun tek interesat e huaja". Më vonë, si president do ta përsëriste se shpërbërja sovjetike "ishte katastrofa më e madhe gjeopolitike e shekullit XX". Një karakteristikë e Putinizmit është ideologjia e restaurimit: ambicia për një restaurim politik, territorial dhe shpirtëror të gjeopolitikës cariste dhe sovjetike. Rusët dhe sllavët shihen si zgjatje të njëritjetrit dhe këto janë premisa bazike e të menduarit dhe vepruarit gjeopolitik.

Në këtë kontekst, vizitat e tij në Serbi i shërbejnë qëllimit sesi Rusia ta këtë njërin këmbë në Ballkan. Për herë të parë, më 17 qershor të 2001-s, ai do ta vizitojë Beogradin dhe kjo po ndodhë pas shumë dekadash që një udhëheqës i lartë nga Moska po qëndronte në kryeqytetin serb. Tema kryesore ishte Kosova. Sipas tij, "stabiliteti në regjion është seriozisht i kërcënuar nga ekstremistët nacionalë e fetarë dhe burimi kryesor është Kosova". Po ashtu, kërkoi që bashkësia ndërkombëtare t'i çarmatosë "terroristët"



shqiptarë. Nëse kjo ndodhë, ai e siguronte bashkësinë ndërkombëtare se Rusia do të bashkëpunojë me të dhe në interes të serbëve në Ballkan, meqë Rusia ka rrënjë të përbashkëta historike sllave ortodokse.

Mandej befas ai e vizitoi edhe Kosovën. Garda ruse e nderit e priti me nderime të larta në Aeroportin e Prishtinës e më pas vizitoi bazën ushtarake ruse jo larg tij, në Vrellë, ku ishin të vendosur rreth 3 000 ushtarë. Duke folur para mediave, ai kundërshtoi kornizën kushtetuese dhe institucionet e përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, edhe pse ato u krijuan dhe buronin nga Rezoluta 1244. Kjo rezolutë ishte negociuar me Rusinë dhe votuar nga ajo në Këshillë të Sigurimit. Natyrisht, as një fjalë për atë se çfarë kishte ndodhur në Kosovë gjatë luftës, spastrimet etnike dhe krimet masive të regjimit serb. Putini gjatë kësaj kohe kishte qenë udhëheqës i FSB, vazhdues të KGB-së dhe natyrisht që e dinte nga dora e parë se çfarë krime çnjerëzore kishte bërë Serbia.

Por duke ardhur nga kundërspiunazhi, ai e njihte mënyrën sesi ta formësonte temën dhe sesi ta shpallte mendimin mashtrues: sulmi mbi Jugosllavinë po ndodhte për shkak të interesave të NATO-s që të zgjerohet në Evropën Juglindore. Fjala krizë humanitare nuk do të ekzistojë asnjëherë në fjalorin politik të

tij apo të Rusisë për ta përshkruar Kosovën në kohë lufte.

## Gjeopolitika etnike

Vëmendja e Vladimir Putinit ishte te serbët në Kosovë, shtypja kinse e shqiptarëve ndaj tyre dhe shkatërrimi i kishave ortodokse serbe. Këtu dhe në raport me serbët në Kosovë, ai filloi ta promovojë brandin e tij, të njohur si gjeopolitika etnike. Putini gjatë kësaj kohe shpesh ka folur për serbët në Kosovë dhe në Bosnjë, duke mos e fshehur pritjen e tij - ata nuk ishin pakica serbe, por instrumente të politikës ruse në Ballkan. Veriu i Kosovës do të bëhet një zonë e pelegrinazhit gjeopolitik rus për dy dekada: nga "konvojet humanitare", prania studentore, media, personel rus në organizatat ndërkombëtare dhe qytetarë privatë. Gjeopolitika etnike si element i doktrinës së tij do të shihet ndërkohë dhe kudo - nga Ballkani, Evropa Lindore e deri te shtetet e Baltikut. Natyrisht në kontekst të popullatës ruse në këto vendet e fundit, interesi dhe intensiteti i angazhimit rus ishte i përmasave të tjera.

Paraardhësi i tij, Boris Jeltsin, respektoi integritetin territorial dhe sovranitetin e ish-republikave sovjetike. Si rrjedhojë, shpërbërja sovjetike që paqësore dhe jo e dhunshme sikurse ishte ajo jugosllave. Putini e ka bërë deri më tash të kundërtën përmes përdorimit

të forcës ushtarake apo edhe luftës hibride. Me instrumente të shumëllojta politike, diplomatike, ekonomike dhe kulturore ka ndërhyrë në disa vende dhe me çdo mjet. Qëllimi është, po ashtu, krijimi i rrethanave jostabile të brendshme duke kërcënuar sigurinë e një vendi të caktuar përmes pranisë ushtarake, paraushtarake apo varësisë politike dhe ekonomike, si pjesë e doktrinës së putinizmit. Kështu e ka futur fillin e një bote të pasigurt jo vetëm në Evropën Lindore, por më gjerë dhe është shndërruar një zëdhënës maniak, që Evropa nuk e ka parë pas vitit 1945.

## Ruajtja e status-qous

Një karakteristikë e putinizmit është ruajtja e status qous dhe moskokëçarja se si një vend qeveriset. Çfarë janë vlerat e sistemit politik dhe në cilat parime është ndërtuar ai, nuk paraqet ndonjë shqetësim. Trupat ruse u tërhoqën nga Kosova më 2003, por Rusia do të mbetet e përfshirë më tutje në administratën e UNMIK-ut dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare. Gjatë kohës kur Kosova po përmbushte standardet e mirëfillta, të vendosura nga OKB dhe UNMIK, Rusia angazhohej ta përmbyste kudo publikisht realitetin e Kosovës. Putini nuk i interesonte ta gjente të vërtetën, por që ta shpallte atë. Ai përdori çdo mekanizëm për të përhapur akuza të rreme ndaj Kosovës, diversion të ndryshëm diplomatik e deri te propaganda agresive globalisht kundër Kosovës. Ishte kjo koha kur po fillonte përcaktimi i statusit final të Kosovës.

Mbajtja e Kosovës në një gjendje të papërcaktuar politike dhe në pafundësi ishte qëllimi rus. Status qou është ajo që Putini e preferon jo vetëm në lidhje me Kosovën, por kudo tjetër. Atë do ta propagandojë personalisht në lidhje me zgjerimin e NATO-s në Evropën Qendrore dhe Juglindore në vitet 2004 dhe 2009. Të njëjtën

qasje do ta ndjekë në raport me zgjerimin e BE-së në Ballkan. Mirëpo, kulmi i përdorimit të magjisë se prishjes së rendit të brendshëm politik dhe prodhimi i situatave të dhunshme ishin në vitet e fundit kur Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut po trokisnin në derën e NATO-s për anëtarësim.

Cilat janë argumentet që përdor Putini në qëndrimet e veta për Kosovën? Ato që vërehen më vonë edhe te vendet e tjera? Në vitet para pavarësisë ai do të flasë për entitetin Kosovë si një vend i dështuar. Kur Kosova përmbushi standardet para statusit, të konfirmuar nga KS i OKB-së, ku Rusia është anëtar i përhershëm, Putini ishte i vetëdijshëm që kjo mund të çonte te sovraniteti gradual i merituar. Ai e përhapte pamjen më të errët për Kosovën në shtypin ndërkombëtar sikurse vendi të ishte buzë kolapsit. Sa më shpejt vazhdonin negociatat nën udhëheqjen e OKB-së për të ardhmen e Kosovës, aq më apokaliptike do të jetë vizioni i tij për Kosovën. Një narracion të tillë të përdorur nga Putini do ta gjejmë para luftës me Gjeorgjinë më 2008, apo para dhe pas aneksimit të Krimesë 2014 dhe ndërhyrjes ushtarake në Ukrainën Lindore. Këtu do ta përdorte trillimin dhe truket e njëjta, të cilat rusët i kishin përdorur për Kosovën në çdo institucion ndërkombëtar. Përfundimi po synon që të imponojë standarde demokratike në Evropën Lindore dhe ato nuk kanë të bëjnë as me traditën dhe as me kulturën e popujve të ndryshëm. Synohej të krijohej përshtypja se në vend të lirisë dhe demokracisë, në shumë vende ku ndërhyrë perëndimoret, të kishte kaos dhe dhunë. Putini akuzon evropianët se "pranverën arabe" pas 2011-s do ta shndërronjë në "dimër arab". Të gjitha këto qëndrime të Putinit janë trillime dhe një diskurs mashtrues që nuk kishin të bëjnë fare me realitetin. (Vijon)

## Slovenia mbështet liberalizimin e vizave për Kosovën

Prishtinë, 18 shkurt (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në një takim ambasadorin sloven Bojan Bertonec. Ai ka uruar Osmanin për detyrën dhe për 12-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë, ka potencuar se politika e

jashtme slovene e ka në fokus Ballkanin Perëndimor. Ambasadori Bertonec e ka konsideruar fazë të re në politikën kosovare, kryesimin e Kuvendit nga ana e Osmanit. Ai ka rikonfirmuar mbështetjen e Sllovenisë ndaj Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave dhe ka thënë se shteti

sloven është për zhvillim dhe bashkëpunim rajonal. Ndërkaq kryekuvendarja Vjosa Osmani ka përmendur investimet slovene në Kosovë dhe ka shtruar nevojën e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet të dy vendeve, posaçërisht në fushën e diplomacisë parlamentare. Ajo e ka njoftuar

ambasadorin sloven me krijimin e grupeve parlamentare të miqësisë, njëri nga të cilët do të jetë ai me Slloveninë. Duke e potencuar mbështetjen slovene në shumë procese, Osmani ka kërkuar që kjo mbështetje të



vazhdojë edhe në procesin e integritetit evropian.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, SHPEJTIM BULLIQI

# Podujeva nuk është



Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka shprehur optimizëm se më 15 mars do ta thyejë bastionin e LDK-së në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se kjo komunë më nuk është bastion i asnjë partie politike. Ai ka treguar se diferenca e vogël e votave në zgjedhjet nacionale në mes të LDK-së dhe LV-së, e bën optimist se do të triumfojë në këtë garë për kryetar komune. Teksa ka shpalosur ofertën për qytetarët e komunës së Podujevës, Bulliqi ka deklaruar se programi i tij prek çdo fushë. Ai ka bërë me dije se ndër prioritetet kryesore të tij është depolitizimi i shërbyesve publikë

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 18 SHKURT** - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka shprehur optimizëm për fitore në zgjedhjet e 15 marsit. Ai ka deklaruar se zgjedhjet e fundit kombëtare kanë treguar se kjo komunë nuk është më bastion i asnjë partie politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Bulliqi është

shprehur i bindur se në këtë garë do ta marrë besimin për ta qeverisur Komunën e Podujevës. “Mendoj se koha e bastioneve ka kaluar në Kosovë. Tanimë asnjë komunë nuk mund të llogaritet se është bastion i këtij apo atij subjekti politik. Ju e dini se në zgjedhjet e fundit nacionale në komunën tonë dallimi në mes të LDK-së dhe LV-së ka qenë mbi 1 000 vota. Prandaj, në këtë aspekt mendoj se më nuk mund ta quajmë Podujevën si bastion të

një partie, nëse diferenca mes këtyre dy subjekteve politike është mbi 1 000 vota. Sigurisht se gjatë fushatës do të angazhohemi fuqishëm që në radhë të parë ta marrim besimin e qytetarëve dhe këtë besim të qytetarëve pastaj ta shndërrojmë në punë dhe angazhime që janë në interes të qytetarëve të Podujevës”, ka thënë ai.

Bulliqi ka bërë me dije se gjatë fushatës zgjedhore i mbetet vetëm ta prezantojë programin e

tij para qytetarëve të kësaj komune. “Unë kam besim të plotë që besimi i qytetarëve të Podujevës nuk do të mungojë për programin tonë dhe për mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje dhe për mua si kandidat për kryetar të kësaj komune. Tashmë nuk kemi dilema në këtë aspekt. Na mbetet që gjatë kësaj kohe të afrohem sa më tepër te qytetari, t’i japim sqarimet konkrete se cili është vizioni ynë për qeverisjen lokale. Ndërsa përkrahja e qytetarëve nuk do të mungojë në këtë aspekt”, është shprehur Bulliqi. Ai ka treguar se në programin të tij përfshinë të gjitha fushat që janë me interes për Komunën e Podujevës. Kandidati i LV-së për kryetar të kësaj komune ka thënë se synon depolitizimin e shërbyesve publikë.

**“Epoka e re”:** Z. Bulliqi, pse vendoset të kandidoni për

kryetar të Komunës së Podujevës?

**Bulliqi:** Janë një sërë arsyesh pse kam vendosur t’i hyj kësaj gare. Së pari, ka qenë kërkesa e qytetarëve të Llapit që të kthehen në këtë komunë dhe ta jap kontributin tim në këtë periudhë kohore në Llap. Opinioni e di se për një kohë të gjatë kam punuar në këtë komunë. Për shtatë vjet e gjysmë kam udhëhequr Drejtorinë e Arsimit dhe gjatë asaj kohe kemi bërë shumë punë të mira. Së dyti, ishte kërkesë edhe e strukturave partiake. Pas një gare të brendshme zgjedhore, kam marrë mbi 95 për qind të votave të gjithë anëtarësisë për të qenë kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje për Komunën e Podujevës. Gjithashtu, ka qenë vullneti dhe dëshira që të kontribuoj në ndaljen e keq-qeverisjes gjatë kësaj periudhe kohore në këtë komunë. Pra, ta sjellim



# më bastion i LDK-së

ndryshimin e pushtetit lokal në Komunën e Podujevës.

**“Epoka e re”:** Cilat do të jenë pikat kryesore të programit tuaj me të cilin do të garoni?

**Bulliqi:** Programi ynë do të mbështetet në të gjitha fushat që janë me interes lokal. Do të fillojmë nga administrata, ku planifikojmë të ndërtojmë një administratë publike profesionale, të paanshme, të përgjegjshme dhe e cila respekton procedurat ligjore. Në fushën e administratës synojmë që të kemi shërbime inovative dhe të digjitalizuara. Brenda administratës do të përqipemi të vendosim aplikacione të reja siç është e-rekrutimi i stafit për të gjitha pozitat e lira në nivel komunal. Për shkak të interesave të qytetarëve, planifikojmë ta zgjerojmë rrjetin e shërbimeve të ndryshme në pjesë të ndryshme të qytetit me e-kioskë. Në fushën e arsimit kemi planifikuar të bëjmë disa reforma, të cilat është dashur të bëhen edhe më herët. Ne kemi për qëllim që t'i ikim bazës partiake të rekrutimit të stafit në këtë fushë, në mënyrë që të kemi shkolla me staf profesional dhe të depolitizuar. Tani fushën e arsimit e kemi shumë të politizuar, duke filluar prej zgjedhjes së drejtorëve të shkollave dhe vazhdohet me stafin tjetër profesional. Synojmë t'i pajisim shkollat me kabinete dhe laboratorë në mënyrë që të zhvillohet mësimi praktik në lëndët ekzakte.

Ndërkaq, në fushën e ekonomisë dhe bujqësisë, mendojmë të bëjmë mbështetje buxhetore për kreditimin e bizneseve prodhuese. Në shëndetësi, mendojmë të ofrojmë shërbime shëndetësore cilësore, pa pritje të gjata të qytetarëve, duke synuar të avancohen shërbimet e ndryshme në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në qendrat që janë jashtë qytetit të Podujevës.

Kemi qëllim ta bëjmë funksionalizimin e objektit të spitalit të qytetit, sepse çështja e këtij spitali të qytetit është bërë sikurse ajo Ura e Shenjtë që sa vite flitet për të, por nuk është realizuar asnjëherë. Mendoj se gjatë mandatit tonë do ta realizojmë atë. Një interes të veçantë do t'i kushtojmë rritjes së stafit profesional shëndetësor, sepse kemi shumë Qendra të Mjekësisë Familjare, sidomos ato nëpër fshatra, në të cilat ka mungesë të stafit profesional mjekësor. Po ashtu, kemi menduar edhe për funksionalizimin e shërbimit të patronazhit, i cili do të ishte shumë i rëndësishëm për zonat e thella rurale, por edhe për kategorinë e popullatës që ka nevojë për këto ndihma në aspektin shëndetësor.

Në urbanizëm dhe ambient planifikojmë të realizojmë një sërë veprimesh, duke krijuar hartat zonale në bashkëpunim me qytetarët dhe ekspertët e këtyre fushave, në mënyrë që të bëjmë një zhvillim të

gjithëmbarshtëm ekonomik e shoqëror të komunës sonë. Infrastruktura, po ashtu, është një prej fushave që ne do t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë. Këtu përfshihet dhe rregullimi i rrugëve në pjesë urbane dhe në ato rurale. Sigurisht se nuk do të bëjmë veprime çfarë kemi parë deri më tani, ku për çdo vit kalendarik është investuar në një rrugë dhe më pas është prishur i njëjti investim. Programi ynë parasheh që t'i kushtojmë një kujdes të veçantë edhe kulturës, rinisë, sportit e kështu më radhë.

**“Epoka e re”:** Sa sfiduese do të jetë gara juaj kur dihet se Komuna e Podujevës është një bastion i LDK-së? Prej pasluftës vetëm kjo parti ka qeverisur?

**Bulliqi:** Mendoj se koha e bastioneve ka kaluar në Kosovë. Tanimë asnjë komunë nuk mund të llogaritet se është bastion i këtij apo atij subjekti politik. Ju e dini se në zgjedhjet e fundit nacionale në komunën tonë dallimi mes LDK-së dhe LV-së ka qenë mbi 1 000 vota. Prandaj, në këtë aspekt mendoj se më nuk mund ta quajmë Podujevën bastion të një partie, nëse diferenca mes këtyre dy subjekteve politike është mbi 1 000 vota. Sigurisht se gjatë fushatës do të angazhohemi fuqishëm që në radhë të parë ta marrim besimin e qytetarëve dhe këtë besim të qytetarëve pastaj ta shndërrojmë në punë dhe angazhime që janë në interes të qytetarëve të

Podujevës.

**“Epoka e re”:** Pra, jeni optimist se do ta thyeni bastionin e LDK-së?

**Bulliqi:** Unë kam besim të plotë që besimi i qytetarëve të Podujevës nuk do të mungojë për programin tonë dhe për mbështetjen e Lëvizjes Vendvendosje dhe për mua si kandidat për kryetar të kësaj komune. Tashmë nuk kemi dilema në këtë aspekt. Na mbetet që gjatë kësaj kohe të afrohem sa më tepër te qytetari, t'i japim sqarimet konkrete se cili është vizioni ynë për qeverisjen lokale. Ndërsa, përkrahja e qytetarëve nuk do të mungojë në këtë aspekt.

**“Epoka e re”:** Përballja kryesore në zgjedhjet e 15 marsit pritet të jetë mes juve dhe kandidatit të LDK-së. Kjo përballje, a mund të ndikojë në koalicionin qeverisës qendror në mes të LV-së dhe LDK-së?

**Bulliqi:** Ne do të garojmë për zgjedhjet lokale. Ndërsa LV-ja dhe LDK-ja kanë bërë koalicion për nivelin nacional, shpresoj shumë se koalicioni LV-LDK të jetë funksional dhe do ta luajë rolin për të cilin është krijuar. Ndërsa, në nivelin lokal, ne nuk kemi ndonjë obligim ndaj njëra-tjetrës, sepse jemi subjekte të ndara dhe garojmë në kushte të barabarta. Sigurisht se qytetarët ditën e zgjedhjeve do të votojnë për kandidatin që mendojnë se është më i miri për ta.

## Policia vret prindërit, dy vëllezërit, pastaj veten

**Qendresa RAMA**

**GJILAN, 18 SHKURT** - Një zyrtare e Policisë së Kosovës në Gjilan ka vrarë katër anëtarë të familjes dhe më pas ka kryer vetëvrasje, ka njoftuar Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda. “Sipas informatave të para, dyshohet se në lagjen ‘Bujanina’, në Gjilan, e ndjera V. B., zyrtare policore, në kuadër të Stacionit Policor në Gjilan, me armë zjarri ka privuar nga jeta dy prindërit dhe dy vëllezërit e saj, pastaj ka kryer vetëvrasje. Në vendin e ngjarjes menjëherë ka dalë policia, prokurori i rastit dhe ekipi mjekësor, të cilët edhe kanë konstatuar vdekjen e tyre, ndërsa me urdhër të prokurorit tru-

pat e të njëjtëve do të dërgohen për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë. Rasti është duke u hetuar, ndërsa për detajet e tjera do të informoheni me kohë”, është bërë me dije në njoftimin e Prokurorisë Themelore në Gjilan.

Nënkoloneli Remzi Azemi dhe prokurori i rastit Arben Kadriu kanë konfirmuar se vrasja nga policia ka ndodhur me armë zjarrtare. “Ishte zyrtare policore aktive dhe dyshohet se ka përdorur armën zjarrtare. Për të gjitha detajet e tjera ju informojmë ndërkohë sepse jemi duke e hetuar”, ka thënë prokurori Kadriu.

Pasi që ngjarja është në hetim e sipër, zyrtarët hetues dhe ata policorë nuk kanë dhënë shumë detaje. “Është ngjarje e

rëndë dhe e ndjeshme, nuk mund të japim më shumë informacione”, ka deklaruar nënkoloneli Azemi, duke shtuar se informacionet rreth rastit do të transmetohen në bashkëpunim me Prokurorinë dhe Inspektoratin e Policisë.

Pasi që rasti është ende në fazën e hershme të hetimeve, nuk dihet motivi që ka çuar deri te kjo vrasje e shumëfishtë.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se shuarja e familjes Bllaca është lajm tronditës. Ai ka njoftuar se në këtë qytet do të ketë një ditë zie në nderim të kësaj familje në ditën e varrimit të tyre, e cila ende nuk është caktuar. “Ka qenë familje e ndershme, sigurisht që Prokuroria ka për ta zbardhur problemin që ka shkaktuar këtë tragjedi. Nuk ka



të bëjë me gjendjen sociale”, është shprehur Haziri, duke shtuar se tragjedia në fjalë është në hetime. “Transmetojeni ngjarjen ashtu siç policia e zbardhë. Është shuar një familje, familje e ndershme, e respektuar. Problemet që ka pasur e kanë

shkaktuar këtë tragjedi që mund të kalohet me solidaritet. Kam takuar institucionet e shtetit dhe jemi marrë vesh për veprimet tona. Komuna do të jetë pranë familjes së mbetur, axhës. Kam propozuar një ditë zije për nder të familjes Bllaca”, ka theksuar Haziri.



## Thyhen për të dytën herë zyrat e AGK-së

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Zyrat e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës janë thyer sërish nga persona të panjohur. Ndryshe nga hera e kaluar, më 06.12.2019 kur u vodhën pajisje me vlerë të organizatës, kësaj radhe në zyrë nuk mungoi asgjë, megjithëse kryesit kanë kon-

trolluar dhe shpalosur dokumentet. "Për rastin është njoftuar menjëherë Policia e Kosovës, ndërsa pas rreth dy orëve në vendin e ngjarjes ka arritur ekipi i Forenzikës për t'i bërë hetimet e nevojshme. AGK-ja është jashtëzakonisht e shqetësuar me këtë situatë dhe e dënon ashpër këtë akt

vandal. Organizata fton organet kompetente që t'i zbardhin të dyja rastet, ani pse për rastin e parë, as pas dy muajsh, nuk ka pranuar asnjë informatë nga hetuesit. AGK kërkon që përgjegjësit për këto incidente të dalin para drejtësisë", është bërë me dije në njoftimin e AGK-së.



## Klinika e Syve ofron mbështetje për spitalet e përgjithshme

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Klinika e Syve e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka filluar ta aplikojë projektin që në thelb ka ofrimin e shërbimeve oftalmologjike me metoda moderne edhe në spitalet regjionale.

Një ekip prej mjekëve specialistë, javën e shkuar, në Spitalin e Prizrenit, ka operuar gjashtë pacientë që kishin probleme me perden e syrit. Me këtë projekt Klinika e Syve synon ta ngritë nivelin e aftësimin profesional të spitaleve regjionale në fushën e oftalmologjisë dhe t'i mundësojë pacientit të marrë shërbime më afër vendbanimit.

Duke e konsideruar të nevojshme, mjekët e syve nga QKUK-ja do të fillojnë prej muajit mars të implementojnë, gjithashtu, metodën e avastinës apo trajtimin me injeksione intravitale në brendësinë e syrit në qytetin e Gjilanit, Mitrovicës dhe Prizrenit.



## Ministri Veliu falënderon OSBE-në për përkrahjen dhënë policisë



PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu, ka pritur të martën në takim njoftues ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu. Siç njofton kjo ministri, në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin e mirë që kanë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike me misionin e OSBE-së në Kosovë. Me këtë rast, ministri Veliu ka falënderuar Braathu për përkrahjen që ka dhënë OSBE-ja për MPBAP-në, me theks të veçantë për Policinë e Kosovës

dhe Akademinë për Siguri Publike, për realizmin e projekteve konkrete që kanë të bëjnë me zbatimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Ministri Veliu ka theksuar se ministrinë do ta bëjë institucion të besueshëm për qytetarët e Kosovës dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Ndërsa ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu, ka theksuar se OSBE-ja do të vazhdojë edhe më tutje përkrahjen e institucioneve të Republikës së Kosovës për krijimin dhe ruajtjen e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e saj.

## Thaçi pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i Danimarkës dhe ai i Kanadasë

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të martën letrat kredenciale nga ambasadori i Danimarkës, jo-rezident për Kosovë, Rene Rosager Dinesen.

Presidenti Thaçi, duke i uruar punën e re ambasadorit Dinesen, u shpreh mirënjohës për përkrahjen që

Danimarka i ka dhënë Kosovës. "E vlerësojmë lart kontributin e Danimarkës qoftë në marrëdhënie bilaterale, qoftë duke kontribuar në misionet ushtarake e civile në Kosovë", u shpreh presidenti Thaçi.

Ambasadori Dinesen u shpreh se Danimarka e përkrah paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe të

ardhmen evropiane të tërë rajonit. Po ashtu, Thaçi ka pranuar edhe letrat kredenciale të ambasadorit të Kanadasë, jorezident për Kosovë, Alan Bowman. Thaçi, duke i uruar sukses në punën e re ambasadorit Bowman, ka shprehur falënderimin e institucioneve të Kosovës për përkrahjen që i ka dhënë Kanada shtetit të Kosovës.





Mbahet tryeza e diskutimit “Dialogu Kosovë - Serbi: Çfarë pas formimit të qeverisë së re dhe përfshirjes amerikane?”

# Reciprociteti dhe taksa përplasin partitë parlamentare



Deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë dhënë qëndrime të ndryshme sa i përket taksës 100 për qind dhe reciprocitetit me Serbinë. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka thënë se taksa e ka humbur efektin e saj dhe nuk po sjell efektet e dëshiruara. Arben Gashi, shef i grupit parlamentar i LDK-së, ka theksuar se qeveria është duke e shqyrtuar heqjen e taksës dhe vendosjen e reciprocitetit. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Daut Haradinaj, është shprehur kundër heqjes së taksës pa njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë. E Haxhi Shala, shef i grupit parlamentar i Nisma-AKR, ka bërë me dije se vazhdojnë ta mbajnë qëndrimin e njëjtë lidhur me taksën

reciprociteti do të zbatohet, ndër të tjera, lidhur me kodin ndërkombëtar tregtar, certifikatat e sigurisë ushqimore/fitosanitare, automjetet e transportit dhe arsimin. Ndërsa, lidhur me reciprocitetin politik në raport me lobimin e Serbisë, ai ka folur për garancitë e plota të bashkësisë ndërkombëtare për ndaljen e kësaj fushate të Serbisë, pa përfshirur veprimet e tjera analoge që mund të ndërmerren.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Daut Haradinaj, ka thënë se opozita do të jetë konstruktive dhe kujdestare e Kosovës së 17 shkurtit të 2008-s. Haradinaj u shpreh kundër heqjes së taksës pa njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë. Sipas tij, taksa ka pamundësuar pretendimet territoriale të Serbisë ndaj Kosovës. Ndërsa në anën tjetër shtoi se “derisa nuk ka njohje reciproke nuk mund të ketë as funksionalizim të reciprocitetit”, është shprehur ai.

Haradinaj ka shtuar se taksa nuk e ka bllokuar dialogun, sepse i njëjti është duke vazhduar dhe janë arritur marrëveshje për autostradën, hekurudhat dhe linjën ajrore mes dy vendeve. Haxhi Shala, shef i grupit parlamentar i Nisma Socialdemokrate-AKR, ka potencuar se vazhdojnë ta

mbajnë qëndrimin e njëjtë lidhur me taksën. Ai ka shtuar se është e paqartë se çfarë do të bëjë koalicioni qeverisës lidhur me bisedimet, si dhe çfarë nënkuptohet me reciprocitetin. “Në bazë të deklaratave të ambasadorëve, edhe reciprociteti, njëjtë sikur taksa, do të jetë bllokuese e procesit. Nëse nga një bojkot ndërkombëtar, për shkak të taksës, po shkojmë te një bojkot i dytë për shkak të reciprocitetit, atëherë pse të lëvizet nga taksa?”, ka thënë ai.

Lidhur me qëndrimin për dialogun, Shala ka shtuar se ata do të jenë konstruktivë dhe kur të ketë platformë të qartë mbi atë se çka do të bëjë ekipi negociues, do të deklarohen se a e mbështesin këtë proces.

Pjesëmarrësit e pranishëm në këtë tryezë kërkuan zgjidhje kreative për zbatimin e taksës dhe reciprocitetit, vazhdimin e dialogut, zbatimin e marrëveshjeve tashmë të arritura, si dhe u diskutua për efektet ekonomike të taksës, sidomos në pjesën veriore të vendit.

Ky diskutim u organizua në kuadër të projektit “Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë” që përkrahët nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të martën tryezën e diskutimit “Dialogu Kosovë - Serbi: Çfarë pas formimit të qeverisë së re dhe përfshirjes amerikane?”, një diskutim mes përfaqësuesve të partive parlamentare, shoqërisë civile dhe medias.

Në hapjen e tryezës, Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, ka theksuar se KDI-ja prej katër vjetësh i ofron asistencë Kuvendit të Kosovës, duke synuar fuqizimin e rolit mbikëqyrës të tij ndaj procesit të dialogut Kosovë - Serbi, për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje qytetare në këtë proces. Kryeziu shtoi se me përfshirjen direkte amerikane procesi i dialogut ka

marrë një dinamikë të re, ndërsa mbetet ende të sqarohen qëndrimet e qeverisë së re lidhur me vendosjen e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë dhe heqjen e tarifës 100 për qind. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka deklaruar që pozita dhe opozita duhet të jenë unike sa i përket dialogut, i cili është në prag të nisjes. Ai ka theksuar se ky është një proces sfidues, i cili duhet të zhvillohet mbi bazën e tri parimeve, përkatësisht që nuk mund të ketë marrëveshje pa dialoguar, nuk mund të ketë dialog me harta dhe procesi nuk duhet të reduktohet në dy individë, qofshin ata presidentë apo kryeministra të dy vendeve. “Taksa do të hiqet kur të krijohen kushtet për zbatim të reciprocitetit me Serbinë. Reciprociteti do të vendoset pasi që të bëhet analiza dhe

skanimi i gjendjes brenda sektorëve të ndryshëm që do t'i ndikojë reciprociteti”, ka pohuar ai.

Abrashi ka shtuar se taksa e ka humbur efektin e saj dhe nuk po sjell efektet e dëshiruara.

Arben Gashi, shef i grupit parlamentar i LDK-së, ka vlerësuar se taksa është përdorur si mjet politik nga qeveria e kaluar dhe ka sjellë dëme politike për Kosovën në raport me bashkësinë ndërkombëtare. Ai ka theksuar se qeveria po shqyrton heqjen e taksës dhe vendosjen e reciprocitetit duke mos i penguar sërish bisedimet e ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht nga ShBA-ja. “Në të gjitha raportet ku Serbia nuk e njeh Kosovën, Kosova nuk do ta njohë Serbinë”, ka deklaruar ai. Në terma konkret, sipas tij,



## Rukiqi: 12 vjet pavarësi, mbeten mjaft sfida për vendin



PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka mbajtur të martën konferencë për medie, në të cilën ka folur për zhvillimet ekonomike në vend. Ai ka thënë se edhe pas 12 vjetësh pavarësi mbeten mjaft sfida për vendin,

siç është shkalla e lartë e rrezikut politik dhe shkalla e lartë e pasigurisë juridike. Sipas tij, tri barrierat kryesore në vend për bizneset mbeten: konkurrenca e padrejtë në vend që është renditur në mesin e top barrierave të raportuara në shkallën 37 për

qind, pasuar nga kamatat e larta në shkallën 36 për qind dhe ekonomia informale me 33 për qind.

Rukiqi ka folur edhe për çështjen e taksës 100 për qind, për të cilën ka theksuar se Oda Ekonomike e përkrah çdo vendim qeveritar që është në

interes të vendit.

Rukiqi gjatë shpalosjes së indikatorit të klimës së të bërit biznes ka pohuar se korrupsioni dhe nepotizmi janë në nivel shqetësues. Sipas tij, rritja ekonomike mbetet e varur nga investimet publike dhe nga remitencat. Rukiqi ka thënë se

Kosova ende ballafaqohet me vendime populiste që po ndikojnë negativisht te bizneset. Sipas tij, Kosova është ndër vendet më të ulëta të ndërmarrësisë në botë, ndërsa ka shtuar se eksporti rrallë tejkalon 350 milionë euro që, sipas Rukiqit, është shumë pak.

## Auditori: Llogaritja e tarifave të shërbimeve publike të bëhet sipas harxhimeve reale

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka rekomanduar që llogaritja e tarifave të rrymës, ngrohjes dhe të ujësjellësit të bëhen sipas harxhimeve reale, saktë dhe drejt. Në raportin "Sistemi i përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike, termike dhe atyre të ujësjellësit", për të cilin është mbajtur një tryezë diskutimi të martën, thuhet se mangësitë po vazhdojnë të ndikojnë në saktësinë e tarifave të energjisë elektrike, ngrohjes dhe atyre të ujësjellësit, me gjithë përparimin e arritur nga rregullatorët.

Në raport shkruan se, përkundër përparimit të arritur nga rregullatorët në procesin e

përcaktimit të tarifave, auditimi ka nxjerrë përfundimin se ka disa mangësi që ndikojnë në saktësinë e tarifave të aprovuara dhe rrezikojnë që tarifafat të mos jenë drejt të përcaktuara.

Ndihmësauditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka thënë gjatë prezantimit se rregullatorët kanë arritur rezultate të mira në dizajnimin e procesit të metodologjisë, të përshtatshme për përcaktimin e tarifave, duke u bazuar në rregulloret dhe procedurat sipas të cilave përcaktohen, shqyrtohen dhe zbatohen tarifafat për shërbime publike. Sipas saj, përkundër përpjekjeve për



zbatimin e mirë të metodologjisë për përcaktim tarifafash, sistemi ekzistues nuk ka siguruar se tarifafat janë caktuar siç duhet.

Raporti i auditimit përfshin një vlerësim të çështjeve relevante për periudhën 2016-2018. Sipas raportit, ZRRE-ja dhe ARRU-ja si

institucione rregullatore kanë zhvilluar një metodologji mjaft komplekse dhe aplikojnë një sistem të dizajnuar mirë për përcaktimin e tarifave. Megjithatë, thuhet se metodologjia për përcaktimin e tarifave nuk është zbatuar siç duhet. "Pavarësisht prej proceseve dhe dizajnit të mirë, kemi vërejtur se metodologjia për përcaktimin e tarifave nuk është zbatuar siç duhet. Gjatë shqyrtimeve tarifore jo të gjithë faktorët janë marrë parasysh dhe, për pasojë, mund të jenë ngarkuar konsumatorët e rregullt të cilët kanë paguar tarifë më të lartë se konsumi i tyre", theksohet në raport.

## Abdixhiku e njofton ambasadorën franceze për projektet e Ministrisë së Infrastrukturës

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të martën ka pritur në takim ambasadorën e Francës në Kosovë, Marie Christine Butel. Në takim njohës ministri Abdixhiku e ka njoftuar

ambasadorën Butel për projektet me prioritet në të dyja dikasteret që ai drejton. Duke shprehur mirënjohje për përkrahje të Francës ndaj Kosovës, Abdixhiku ka theksuar se beson në vazhdimësi të bashkëpunimit të mes të dyja shteteve.





# Mbi 148 mijë vetura të peregjistruara sfidojnë Kartonin e Gjelbër

PRISHTINË, 18 SHKURT - Përpjekjet e autoriteteve në Kosovë për anëtarësim në Këshillin e Byrove Evropiane, që siguron Kartonin e Gjelbër, po sfidohen nga dy probleme thelbësore. Së pari, Kosova nuk është shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe, së dyti, në Kosovë ka një numër të madh të automjeteve të peregjistruara, të cilat janë edhe të pasiguruara në qarkullim, çka e bën të pamundur sigurimin e Kartonit të Gjelbër.

Kartoni i Gjelbër vërteton se një automjet përfiton në mënyrë të mjaftueshme nga mbulimi i përgjegjësive nga sigurimi. Kështu, kur makina përfshihet në një aksident në territorin e një shteti ku vlen sistemi i Kartonit të Gjelbër, sigurimi mbulon koston (e lëndimit, dëmtimit etj).

Blerim Pushkolli, drejtor ekzekutiv në Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS), në një përgjigjeje për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se parakushtet e tjera të kërkuara nga Këshilli i Byrove në vitin 2011 janë plotësuar qysh kur është dorëzuar edhe aplikacioni për anëtarësim. "Mirëpo mosanëtarësimi në OKB vazhdon të na penalizojë në procedim të mëtejshëm në lidhje me pranimin e Kosovës në këtë Këshill", ka thënë ai.

Këshilli në atë kohë, rikujton Pushkolli, kishte kërkuar që Kosova ta miratojë Ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Qendrës Informativë si dhe Fondin Garantues në shumën prej 4 milionë eurosh, kushte këto që, sipas tij, janë përmbytur. Por, përveç mosanëtarësimin të Kosovës në OKB, problem mjaft serioz, thotë

Pushkolli, paraqet numri i automjeteve të peregjistruara. Ai kërkon përkushtim nga drejtorja e Policisë Rrugore të Kosovës dhe, po ashtu, edhe të institucioneve të tjera shtetërore që kjo çështje të rregullohet si në vendet e Bashkimit Evropian.

Fokusi aktual i BKS-së është në uljen e këtij numri të veturave të peregjistruara, pasi që paraqitet si një prej parakushteve teknike për anëtarësimin e Kosovës në sistemin e Kartonit të Gjelbër. Mirëpo, sipas BKS-së, për t'u arritur një gjë e tillë duhet që përqindja të ishte jo më pak se 2 për qind e veturave të peregjistruara dhe pasiguruara. Aktualisht ky numër, sipas BKS-së, rezulton të jetë nga 35 deri në 50 mijë.

Edhe drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve, Sami Mazreku, thotë se numri i automjeteve të peregjistruara, përveçse paraqet problem në sigurimin e Kartonit të Gjelbër, paraqet rrezik serioz për jetën e qytetarëve, pasi që automjetet e tilla nuk iu kanë nënshtruar fare kontrollit teknik si veprim i obligueshëm ligjor para regjistrimit të automjetit.

Prandaj, thotë ai, është e domosdoshme që institucionet e vendit, në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), të nxjerrë rregullore apo edhe udhëzime përmes të cilave kërkohet që qytetarët që nuk i përdorin veturat, t'i ç'lajmërojnë, derisa ata që i përdorin, t'i regjistrojnë ato. "Për të sjellë rregull në këtë drejtim, praktikat ekzistojnë dhe ne vetëm duhet t'i marrim dhe t'i zbatojmë", ka deklaruar Mazreku.

Drejtorja për Regjistrimin e Automjeteve në bashkëpunim me Policinë e Trafikut janë duke punuar në atë drejtim që për



këto raste të aplikohen gjoba për pronarët e mjeteve që nuk e deklarojnë mjetin se ku ndodhet pasi t'i ketë skaduar regjistrimi, thuhet në një përgjigjeje për "Radion Evropa e Lirë" nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Numri i veturave të peregjistruara në territorin e Kosovës, sipas kësaj ministrie, është 148 mijë,

kurse i veturave të çregjistruara 51 mijë. Ndërkaq, automjete të regjistruara, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë 356 mijë. Sidoqoftë, deri tek anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Byrove të Evropës, të gjitha veturat me tabela të huaja, të cilat hyjnë në territorin e Kosovës, sipas ligjeve në fuqi, duhet të paguajnë një shumë për tarifën e

sigurimeve kufitare, varësisht nga lloji i automjetit dhe koha e qëndrimit në Kosovë.

Sipas të dhënave të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, të hyrat nga primet e Sigurimit Kufitar për vitin 2019 kanë qenë rreth 7.7 milionë euro, kurse pagesa e dëmeve të paguara për periudhën e njëjtë rezulton vlerën prej 7.9 milionë eurosh.

## Ministri Mustafa merr përkrahje nga UNDP-ja për mbështetjen e sektorit të pylltarisë



PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka pritur të martën në takim një delegacion të UNDP-së, i kryesuar nga koordinatoreja e zhvillimit për Kombet e Bashkuara në Kosovë, Ulrika Richardson. Gjatë këtij takimi është biseduar për zhvillimet e përgjithshme në sektorin e bujqësisë, me theks të veçantë në sektorin e pylltarisë.

Ministri Mustafa i ka njoftuar ata për objektivat e MBPZhr-së për këtë vit si dhe planet e ministrisë për investimet në

sektorin e pylltarisë. Me këtë rast, ministri ka marrë mbështetjen nga koordinatoreja Richardson për përkrahjen e mëtejme të projekteve për zhvillimin e zonave rurale, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së punësimin në vend.

Në anën tjetër, koordinatoreja e zhvillimit për Kombet e Bashkuara në Kosovë, Ulrika Richardson, ka theksuar se si institucion do ta vazhdojnë përkrahjen e sektorit të pylltarisë në Kosovë përmes projekteve të ndryshme.



# Politika serbe e kryqëzuar midis Kishës dhe Akademisë



Prof. Lisen BASHKURTI

Në dukje të parë po krijohet përshtypja se diplomacia perëndimore, ShBA-ja dhe BE-ja, po lëvizin drejt trajektores Serbi-Kosovë, për të shkuar drejt një marrëveshje të shumëpritur por, në të vërtetë, larg për t'u arritur. Edhe Kosova po lëviz në mënyrën e saj, ndonëse jo krejt e qartë dhe jo në mënyrë kohezive. Krahu më i ngurtë, që nuk po lëviz fare nga pozicioni i saj, është Serbia, e mbështetur në mënyrën e vet nga Rusia. Pra, kemi qartazi të bëjmë me një dinamikë diplomatike asimetrike: Perëndimi po nxiton dhe Kosova po lëviz, ndërsa Rusia po frenon dhe Serbia po bllokton. Një situatë e tillë diplomatike asimetrike, ku njëri krah lëviz me nxitim ndërsa krahu tjetër bllokton me qëllim, është shkaktuar më së shumti nga fakti se në aksionin diplomatik perëndimor aktual në Ballkan janë përfshirë liderë politikë dhe aktorë diplomatikë që e njohin pak ose aspak politikën dhe diplomacinë serbe dhe prapavijën e saj ruse dhe për këtë arsye mund të bien lehtësisht në kurthin e tyre. Në thelb, Serbia është viktimë e vetvetes. Dhe, si e tillë, është e gatshme t'i viktimizojë edhe vendet e popujt përreth saj. Do të ishte luzion mjeran, nga politika dhe diplomacia perëndimore, të mendohej se Serbia është në duart e Vuçiqit, sado i fuqishëm që të jetë ai politikisht. Për të kuptuar këtë situatë është e domosdoshme të depërtohet në aktorët dhe procedurat e vërteta të politikëbërjes dhe vendimarrjes në Serbi.

## 1. Kisha serbe, pronare e politikës dhe diplomacisë së saj

Kleri serb ka pronësi të fortë mbi historinë politike të Serbisë. Historia e Serbisë është në thelb historia e kishës ortodokse të saj. Historia e përgjithshme, por edhe historia kishtarë pravoslave serbe pohon se kleri ortodoks serb dhe institucionet e tyre kanë qenë dhe kanë mbetur aktive gjatë tërë kohës. Madje, roli i klerikëve dhe monakëve theksohet me ditirambe të veçanta pasi monakët dhe klerikët kontribuan "jo vetëm me kryq në dorë dhe me qaforet rreth qafës, por edhe me shpatë,

pistoletë në brez dhe pushkë në krah". Shumë prej tyre shkuan në luftë jo si kryqtarë popullorë, por si ushtarë të thjeshtë. Në shekullin 19 ky aktivitet është shfaqur gjatë kryengritjes së përgjithshme kundër Turqisë. Kryengritjet në Shumadi 1804, në Zhicko Polje në 1806, në Lopas në 1806, në Dragashevë në 1807, klerikët ortodoksë serbë në mobilizimin e njerëzve, por edhe me shembull ushtarak personal. Kleri serb ka pronësi të fortë edhe në diplomacinë serbe sepse klerikët serbë kanë qenë dhe mbeten aktivë edhe në diplomaci. Prota Matija është organizatori kryesor i serbëve përtej Kollubarës në vitin 1803 kundër Turqisë. Proto Matija ishte në Petrograd te Cari rus Aleksandër, në Greqi dhe në vende të tjera me misionë kishtarë e diplomatike. Aktiviteti kishtar serb brenda dhe jashtë nuk pushoi deri në ditët tona. Në këtë veprimtari kisha serbe ruan dhe përçon frymën shoviniste të politikës dhe diplomacisë serbe. Kleri serb ka krijuar simbiozën e pashqitshme fe-politikë. Në jetën fetare dhe politike serbe organet më të rëndësishme janë sinodet ose kuvendet e etërve të shenjtë. Sinodet janë të përgjithshme dhe ndërkombëtare, por janë edhe specifike dhe lokale. Të njohur si kuvendet vasseljane, këto institucione kanë qenë dhe mbeten më të rëndësishmit në jetën shpirtërore të Serbisë dhe me ndikim absolut mbi politikën dhe shtetin e saj. Kleri serb ka mitifikuar historinë e Ballkanit, të Serbisë dhe të Kosovës. Sipas saj, martiri i serbëve, Princ Llazari, ka luftuar për një popull qiellor dhe në një tokë qiellore, që është Kosova, Jerusalemi i ri i Zotit. Këtyre dogmave fetare historia serbe i ka bërë jehonë me tezat fikse. Shkenca serbe, sidomos historia, gjeografia nuk kanë dalë asnjëherë jashtë kuadrin të dogmave të përcaktuara nga kisha serbe. Dogmat e kishës serbe kanë qenë themeli mbi të cilën janë ngritur historia dhe gjeografia e Serbisë e, siç dihet, historia dhe gjeografia të manipuluar serbe janë prindërit e politikës së saj. Burimet kryesore të doktrinës fetare-politike serbo-sllave janë edhe kronikat e murgjve serbë, që shprehin në vetëdijen tribale, popullin serb deri në ditët e sotme. Kjo ideologji, në vend të kombit e thekson popullin, në kuptim të "popullit qiellor", madhësia e të cilit nuk është raca, por "dhurata e Zotit". Sipas klerit serb, kjo hyjni nuk dihet përse u është privuar popujve të tjerë, por u është dhënë vetëm serbëve

në Kosovë. Në këtë mënyrë, shkenca dhe teoritë shkencore ia lëshojnë vendin mitologjisë dhe religjionit, që ky të transformohet në doktrinë fetare-politike serbe për ta konfirmuar këtë lajthitje. Konceptet politike, religjioze, ushtarake ekstreme dhe perverse serbe-ortodokse kanë ndikuar që edhe njerëzit më përgjegjës të ortodoksizmit, të politikës dhe të shkencës, të bien në kurthet vicioze, mistike dhe obskurantiste. Vetëdija e tillë dogmatike dhe perverse ka krijuar dhe krijon psikopati politike e religjioze, të cilët gjatë historisë humbjet i konsiderojnë si fitore, kurse 'zotimin' për Kosovën e bëjnë fundament për luftëra gjenocidale. Kjo vetëdije dogmatike, mistike dhe obskurante e shtynë edhe sot Kishën Ortodokse serbe, peshkopin Artemije të nxisin ekstremizmin e dhunshëm, duke manipuluar masat serbe me eshtrat e princ Llazarit, i cili burimet e veta nuk i ka të shenjtja, por i ka nga lëvizja hajdute e çetnike, që provohen dukshëm nga kronikat e përmendura më herët nga epika mesjetare serbe. Kleri serb, për arsyet e mësipërme, nuk e lëshon pronësinë mbi politikën, diplomacinë, shkencën e Serbisë. Me një autoritet absolut mbi vetëdijen popullore serbe, kleri serb kontrollon me një dominim të padiskutueshëm politikëbërjen dhe vendimarrjen në Serbi. Rreth tij, vërtiten si kukulla, liderët dhe institucionet politike serbe. Çdo përpjekje e politikanëve serbë për të dalë nga ky rreth vicioz dogmatik, mistik dhe obskurant i klerit është shoqëruar më së paku me largimin nga skena politike, më së shumti me eliminimin fizik të tyre.

## 2. Akademia serbe, autore e doktrinave nacional-shoviniste

Lëvizja nacionaliste shtetformuese serbe në shekullin 19 është paraprirë dhe bashkëshoqëruar ngushtësisht nga akademikët serbë. Ilija Garashanini, i pari shtetar modern, ministër i Brendshëm dhe kryeministër i Serbisë, përgatiti elaboratin e tij në vitin 1844 me emrin 'Načertanije'. Ky dokument udhëhoqi politikën serbe drejt aspiratës për 'Serbinë e Madhe'. Dokumenti mbeti sekret deri në vitin 1906, duke ndikuar vetëm në qarqe politike, por jo popullore, së paku gjatë shekullit 19. Të pakënaqur nga mosrealizimi i platformës së Garashaninit, akademikët serbë të shekullit 20-të, në krye me Vasa

Çubriloviqin, avancuan më tej në programin e tyre politik. Dr. Vaso Çubriloviq ka qenë këshilltar i regjimit monarkist, pastaj ministër, akademik, drejtor i Institutit të Ballkanologjisë dhe anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore. Ky akademik serb botoi memorandumun e tij "Dëbimi i shqiptarëve", që iu paraqit qeverisë mbretërore të Stojadonoviçit më 7 mars 1937, dhe ka shërbyer si platforma kryesore për spastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë. Memorandumi i Çubriloviçit mbetet valid edhe sot për politikën serbe. Nuk ka asnjë dokument, asnjë rezolutë, apo edhe deklaratë qoftë edhe individuale nga akademikët serbë deri më sot ta kenë kontestuar memorandumun e Çubriloviçit. Është rast unik në botë në historinë e akademizmit që një akademik të ketë hartuar një platformë që arsyeton dhunën, gjenocidin dhe pastrimin etnik të një populli dhe, çfarë është edhe më e rëndë, që nuk kontestohet as edhe nga një zë i vetëm akademik. Në frymën e Çubriloviçit mendon, sillet e vepron edhe sot Akademia e Shkencave dhe Arteve e Serbisë. Kështu, historiani dhe akademiku serb Vasilije Krestiq ka thënë pak kohë më parë se "Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë për çfarëdo çmimi nuk do të heqë dorë nga Kosova". "Në pikëveshtrimin tim, thotë ai, Akademia do të qëndrojë në pikën ku nuk do t'i çojë duart nga Kosova dhe Metohija, për asnjë çmim". "Kjo është pse nuk ka një njohje formale të shtetit të vetëshpallur nga shqiptarët në Kosovë", ka thënë ai.

Si politika zyrtare e Serbisë, ashtu edhe ajo e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (ASHAS) i kanë vënë vetes qëllim "mbrojtjen e interesave të popullit serb në rajon, i cili ishte dhe është imperativ politik, historik dhe moral", shprehen Ivica Daçiq e Vuk Jeremiç, të cilët shpeshherë do të deklaronin se "është normale që prioritet për ne janë pozitat e serbëve në rajon...". Në këtë linjë, në mënyrë të programuar janë shprehur edhe akademikët Dobrica Qosiq e Lubomir Tadiç, të cilët përgatitën Memorandumin 2 (2011), të ASHAS, i cili, për dallim me Memorandumin e vitit 1986, është dokument konfidencial, i cili u është dërguar anëtarëve të kabinetit qeverisës për lexim, por "pa shpërndarje të mëtejshme". Në përgjithësi pikëpamjet e akademikëve aktualë serbë për

Kosovën, të publikuara deri më tash në mediat serbe, nuk dallojnë nga ato që ishin shprehur në memorandumun e kësaj akademie në fund të viteve '80, të cilat i kanë nxitur aspiratat ekspansioniste të Serbisë dhe kanë çuar në luftëra të përgjakshme midis Serbisë dhe njësive të tjera të federatës së ish-Jugosllavisë, e posaçërisht në Kosovë. Kohët e fundit, në Akademinë Serbe të Shkencave dhe Arteve ka edhe anëtarë që kanë pikëpamje më të avancuara lidhur me çështjen e Kosovës. Një ndër ta është edhe kryetari i kësaj akademie, Vladimir Kostiq, i cili vlerëson se Serbia e ka humbur Kosovën dhe lidhshipi politik dhe opinioni serb duhet ta kuptojë këtë. Për shkak të këtyre pikëpamjeve, Kostiq ka qenë në shënjestër të sulmeve brenda dhe jashtë Akademisë, sidomos të udhëheqjes shtetërore të Serbisë.

Latinka Peroviç, akademike serbe, ka ngritur zërin kritik për instrumentalizimin politik të akademikëve në Serbi. "Në vend se politikanët të mësojnë nga njerëzit e dijes, thotë ajo për politikanët serbë, ata i thërrasin për dëgjueshmëri". Ndër zërat e pavarur dhe të përgjegjshëm ka qenë edhe akademik Vladimir Kostiq, që ka ngritur zërin për domosdoshmërinë që akademikët të mbesin jashtë politikës, me qëllim që të mund të jenë politikisht të paanshëm. Por, këta zëra të vetmuar dhe të izoluar në mjediset akademike serbe nuk e thyjnë dot mjedisin e fuqishëm dhe të indoktrinuar nacional-shovinist të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë.

## 3. Diplomacia perëndimore, pa ndikim mbi Kishën dhe Akademinë Serbe

Një nga arsyet që procesi diplomatik perëndimor me Serbinë po vërtitet në një rreth të mbyllur pa rrugëdalje, është pikërisht për faktin se diplomacia perëndimore është fokusuar te lidhshipi politik e diplomatik serb, ndërkohë që ky i fundit është i kryqëzuar midis Kishës dhe Akademisë Serbe. Perëndimi dhe diplomacia e tij nuk depërton dot fare në kishën serbe, ndërkohë që ka fare pak ndikim mbi individë të veçantë të Akademisë Serbe. Në Perëndim, shteti, politika dhe diplomacia janë të ndara prej shekujsh nga feja, doktrina e institucionet e saj. Ky reformacion i Perëndimit e bën të pamundur që politika dhe diplomacia e tij të mund të depërtojnë e aq më pak të



# Çfarë solli Samiti i Munihut në mes të Kurtit e Ramës



Bedri ISLAMI

A mund të transferohet zyra qendrore e Lëvizjes Vetëvendosje në selinë kryeministore, pra, a do të jetë e mundur që idetë, mendimet, përpjekjet e synimet e një lëvizje politike, e cila ishte fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit, do të mund që, në një periudhë të shkurtër, të jenë pjesë e programit politik, financiar, social dhe jetësor të shtetit të ri të Kosovës?

Kjo është më thelbësorja në të gjithë këtë periudhë, e cila, edhe pse është tejet e paktë, nga njëra anë për të gjykuar dhe, nga ana tjetër për ta bërë opozitën e mundshme, përsëri është lënë mënjanë nga analistë, media dhe funksionarë të ndryshëm.

Në të gjithë këto ditë të para të një qeverisje që sapo nisi, më shumë vend kanë zënë debatet rreth gjuhës së trupit dhe të turpit, të forcës që tregoi Kurti në Samitin e Munihut dhe si ia mblodhi presidentit serb, entuziazmi naiv se pas kësaj gjithçka do të rrokulliset ndryshe dhe se, më në fund, Perëndimi ka përballë vetes një lider që nuk e mundin dot, të pakorruptuar, pa hije në vitet e luftës së UÇK-së etj.

Samiti i Munihut tregoi gjëra të tjera që janë më të rëndësishme sesa të gjitha këto së bashku.

Së pari, jo vetëm de jure, por edhe de fakto, Albin Kurti është kryeministri i ri i Kosovës dhe këtë detyrë e ka marrë shumë seriozisht. Si duket, troshitja e bisedimeve me rivalin politik të LDK-së ka kaluar ashtu si kanë kaluar edhe çastet e një luhate mes të qenit në qeveri apo edhe një sprovë e madhe politike përmes rikthimit në zgjedhje.

Ai mund edhe të gabojë apo të nxitohet në disa deklarata politike, sidomos kur e ndien veten se ende nuk e ka marrë seriozisht, por e gjithë paraqitja e tij në Samitin e Munihut solli këtë mesazh: ai është shefi i Qeverisë së Kosovës dhe këtë, duan apo nuk duan, është mirë ta kuptojnë të gjithë. Edhe ata që janë në Prishtinë, edhe ata që janë në Tiranë, por edhe të tjerë, jashtë Prishtinës dhe Tiranës.

Nënshkrimi i një marrëveshje, e rëndësishme apo e parëndësishme qoftë, e nisur nga qeveria e shkuar, aq më tepër me një shef të dorëhequr, nuk duhej vënë në tryezën e nënshkrimit pa u informuar shefi i ri i Qeverisë së Kosovës dhe institucionet e reja të këtij shteti.

Së dyti, në kaq shumë vite jetë plurale, shpeshherë, për të mos

thënë gjithnjë, sipërina politike e shtetit shqiptar e ka parë veten në rolin e një tutori mbi politikën shqiptare të Kosovës. Ka qenë një paternalizëm i pështirë, korocatën e të cilit e hoqi në fillimet e qeverisjes së tij Edi Rama, por që synoi ta mbështjellë përsëri.

Edhe vetë politika shqiptare në Kosovë e pranoi këtë tutelë dhe e bëri si një shpatë në politikën e saj. Kaq ishin trulllosës pas kësaj dallie tutoriale, saqë edhe diçka që vërehej lehtësisht, si ftohja akullnajore e Berishës me Rugovën, nuk vihej re, por vazhdon ekzaltimi politik e medial.

Tani kjo ishte e qartë edhe në Samitin e Munihut, paternalizmi ka fundin e tij. Për fat të keq, është shkuar edhe përtej saj: në një ftohje politike mes dy shteteve me kombësi të njëjtë dhe nga dy liderë që, në kohë të ndryshme, janë shprehur pro bashkimit të kombit.

Asnjëherë më parë nuk ka qenë kaq e tronditur kjo përbashkësi saqë vetëm ekzaltimi i fillojugosllavëve në Prishtinë, më shumë dhe, në Tiranë, më pak, do të ishte më se e mjaftueshme, për të vërejtur se sa e hidhur është kjo fillesë.

Kjo ndasi ka kohë që është shfaqur dhe tani është më e dukshme jo se janë ndërruar qeverisjet në njërën shtet dhe në shtetin tjetër kanë hallet e tyre, por sepse edhe radhitja e shefave të tashëm të qeverive ka qenë diametrisht e ndryshme e shpeshherë e kundërt.

Ndërsa Edi Rama ishte rreshtuar në krahu politik të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, kundërshtari i Thaçit në Kosovë, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Kurti, bëri rreshtimin e tij krahas forcave që ishin kundër qeverisjes së Rilindjes.

Kurti shkoi edhe më tej, duke ndjell dhe shpallur "pranverën shqiptare", një analogji pa vend me pranverën arabe, e cila, sipas Kurtit dhe dishepujve të tij në Tiranë, do të përmbyste një qeveri e cila ishte zgjedhur normalisht, ishte e ligjshme, pavarësisht

qeverisjes së prapstë.

Tani marrëdhëniet mes dy shteteve futen në një mjedis të ri politik: barazinë mes tyre dhe krijimin e një raporti të ri politik, ku secili është i barasvlershëm dhe drejtues në vendin e tij.

Ndoshta kjo edhe duhej pritur, kur, për më tepër, të dy liderët kanë egon e tyre politike, rrugëtimin e tyre politik dhe përzgjedhjet e tyre.

Dallimet mes makro-shengenit shqiptar dhe mini-shengenit ballkanik, më tepër se përzgjedhje të ndryshme politike, janë mendësi të ndryshme të cilat do ta kenë rrugën e gjatë drejt zgjidhjes së një mesore të mundshme.

Së treti, Albin Kurti është në fillimin e provës së tij si njeri i pushtetit, ndryshe nga sa ishte deri tani, njeri i antipushtetit. Në 20 vjetet e pasluftës në Kosovë Kurti ka qenë e mbetet opozitari më i përshfaqur, më i ashpër, solid dhe nganjëherë në teprimin e veprimeve të tij, i paqenë në pushtetin qendror, elokuent në opozitarizmin e tij, që nganjëherë tejkalonte edhe përdallimin mes njeriut që do të bëhej burrë shteti dhe opozitarit që kishte vendosur ta rrëzonte binan e madhe të pushtetit.

Mes pushtetit, si drejtues dhe antipushtetit, si krijues i një fronti opozitar, qëndrojnë ndasi të mëdha, të cilat nuk duan t'ia dinë për 100 ditët e para të qeverisjes Kurti. Më shumë se sa mënyrë pune, ata janë koncept. Më tej sesa ide, janë vizion. Më tepër sesa përcaktim, janë detyrim i tashëm, ku nuk pyetet për deklaratat politike të Kurtit, as për zemërimin dhe mërzitjen e Edi Ramës, as për pëlqimet politike të kryeministrit të Kosovës në shtetin amë dhe as për rishikimin e gjithë historisë 20-vjeçare nga e para.

Kurti mori anën e tij të gabuar politike, kur u rreshtua në ballinën e atyre që, duke qenë opozitë e pafuqishme në Tiranë, i rrahën shpatullat atij për të fituar përmes një figure politike që ende kishte ndjesinë e njeriut idealist. Hesapet e Tiranës nuk zgjidhen

në Tiranë, por as hesapet e Tiranës nuk paguhen në Prishtinë. Më shpejt se gjithë tjerët këtë do ta kuptojnë shefi i ri i qeverisë së Kosovës dhe, jam i bindur se, telashet në shtetin që do të drejtojnë, do të jenë aq të shumta e aq hallemëdha, saqë meritë politike të Tiranës do t'i duken të largëta e jo rrallëherë të huaja.

Së katërti, për Albin Kurtin tani është koha e provës. Ecja patriotike vjen e mbaron një ditë. Tani fillon qeverisja dhe në Samitin e Munihut, jo rastësisht, Kurti mori e dha mësimin e parë se ka filluar ta qeverisë Kosovën. Qeverisja e Kosovës është puna më e vështirë që ka ai përpara vetes. Së shpejti para tij do të shtrohen pyetjet më të vështira, të cilat kanë të bëjnë me vetë jetën në Kosovë, raportet mes tij dhe shefit të presidencës, i cili, ndoshta si askush tjetër, gëzon besimin e ndërkombëtarëve, qëndrimi ndaj Zajednicës, një profil i rrezikshëm politik dhe administrativ serb, ndaj të cilit ai ka qenë gjithnjë kundër, por që bashkë aleati i tij, Mustafa e ka nënshkruar; raportet dhe bisedimet e pritura me shtetin serb, të zhdukurit dhe pakicat serbe në Kosovë, raportet e Qeverisë së Kosovës me ShBA-në dhe BE-në, por edhe me strukturat e tyre në Kosovë e, mbi të gjitha, ekonomia e Kosovës.

Për Kurtin dhe qeverinë e tij tani fillon puna, e cila nuk matet as me thirrjet "urra" të Berat Buzhalës, as me deklaratimet e vonuara patriotike të fillojugos Veton Surroi, as me çjerrjet patetike të një grupi analistësh, të njohur si kundërshtarë të shefit të qeverisë shqiptare, Edi Rama, e as me rrahjen e shpatullave nga opozita në Shqipëri, as nga mërzitja e Edi Ramës dhe, në fund të fundit, as me gurët që do t'i hedhin në rrugëtimin e tij si kryeqeveritar i Kosovës.

Shumë gjëra nga ato që i ka pasur për zemër dikur nuk do t'i ketë më; shumë thirrje patetike të mbështetësve të tij nuk do të kenë më vend, dëliri i ditëve të para do t'ua lëshojë vendin halleve konkrete.

Të gjithë do të gëzoheshin nëse punët do t'i vënin mbarë.

E çuditshme është e, ndoshta, aspak e çuditshme, që mbështetësit më të mëdhenj të sotëm të një lideri majtist janë të djathtët në Kosovë, fillojugosllavët, e djathtët shqiptarë, analistë që ishin kundër luftës çlirimtare... e jo pak herë edhe kundër qëndrimeve të tij.

Nëse ata e shohin Albin Kurtin si një kalë beteje, jam i bindur se shpejt ata do të bien, dhe do t'i kthehen pikërisht këtë që e lartojnë tani.

Mos u çudit, ky është zanati i tyre, Albin!





## Komuna e Deçanit hap konkurs për dizajnimin e stemës së komunës



DEÇAN, 18 SHKURT (ER) - Pas miratimit të statutit të ri të Komunës së Deçanit është hapur rruga që edhe stema e Komunës së Deçanit të ndryshohet. Për këtë është formuar edhe një komision në asamblenë komunale në këtë përbërje: Bashkim

Ramosaj, kryetar komune dhe kryetar i komisionit; Halil Tolaj, drejtor i inspeksionit; Rexhë Sutaj, asamblist (AAK); Lirije Zukaj, asambliste (AAK); dhe Kestrim Avdimetaj, asamblist (PDK). "Konkursi është i hapur nga data 18.02.2020

në afat prej 30 ditëve. Ftohen të gjithë njohësit e kësaj fushe që të bëhen pjesë e këtij konkursi me idetë e tyre që të nxjerrim më të mirën e mundshme për stemën e Komunës së Deçanit", është theksuar në njoftimin e kësaj komune.

## Komuna e Prizrenit dhe 'Caritas'-i zviceran mbajnë takim informues me fermerët prizrenas

Prizren, 18 shkurt (ER) - Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim me organizatën "Caritas"-i zviceran, do të organizojë takim informues me fermerët prizrenas lidhur me grantet që do t'u shpërndahen fermerëve për mbështetjen dhe promovimin e prodhimit të bujqësor në Komunën e Prizrenit.

Takimi informues do të mbahet sot (e mërkurë) në orën 11:00 në sallën e objektit të administratës komunale (tek ish-'Bankosi'). "Projekti i mbështetjes së fermerëve nëpërmjet granteve ka për qëllim përmirësimin e

kushteve jetësore të fermerëve, rritjen e gjenerimit të të hyrave dhe prodhimin bujqësor në Komunën e Prizrenit. Duke u bazuar në kërkesat e tregut dhe pas analizave të hollësishme 'Caritas' zviceran ka zhvilluar modelin e granteve që do t'u jepen fermerëve për kultivimin e frutave manore dhe bimëve mjekësore aromatike", ka njoftuar Komuna e Prizrenit. Sipas kësaj komune, qëllimet kryesore të projektit janë: promovimi dhe prodhimi i frutave manore, bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), certifikimi i fermerëve me standardet e prodhimit të

organike për kultivuesit e BMA-ve, certifikimi i fermerëve me standardet e prodhimit të integruar për kultivuesit e frutave manore (dredhëza, mjedra, boronica), edukimi, trajnimi dhe ngritja e vetëdijes së fermerëve për prodhimtarinë bujqësore dhe themelimi i zinxhirit të vlerave për kultivuesit. "Ky model është një mundësi unike për fermerët për të zhvilluar dhe kultivuar produktet bujqësore në Kosovë dhe ka një qasje të orientuar nga tregu që vjen si rrjedhojë e kërkesave të tregut dhe të trendëve globale", ka njoftuar kjo komunë.



## Kamenica, pjesë e ekspozitës 'Iniciativa për shkëmbim kulturor ndërkomunal'



KAMENICË, 18 SHKURT (ER) - Forumi Lokal për Trashëgimi Kulturorë i Komunës së Kamenicës ka marrë pjesë në ekspozitën e cila është hapur në kuadër të projektit "Iniciativa për shkëmbim kulturor ndërkomunal" (MAKS FORUM) që është

organizuar nga "CHWB Kosovo" dhe "IBPE Skopje" dhe financohet nga Bashkimi Evropian. Gjatë hapjes së kësaj ekspozite është thënë se ky projekt ka qenë një mundësi e mirë për t'u njoftuar

me potencialin e trashëgimisë kulturore të tri komunave partnere të projektit në Kosovë si: Vita, Hani i Elezit dhe Kamenica, po ashtu edhe komunave partnere nga Maqedonia e Veriut.

Lista prioritare e objekteve të trashëgimisë kulturore në Komunën e Kamenicës në këtë projekt përmban pesë xhami si dhe Mullirin Binjak, objekt i cili është përzgjedhur për restaurim.

## Afrim Sylaj, komandant i Stacionit Policor në Suharekë

Suharekë, 18 shkurt (ER) - Kapiten Afrim Sylaj është emëruar komandant i Stacionit Policor në Suharekë. Me këtë

rast, kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, i ka uruar Sylajt suksese në detyrën e re. "Sot e kam uruar

për detyrën e re, duke i uruar suksese në punë. Siguria e qytetarëve është prioritet edhe i institucioneve komunale,

prandaj angazhimi i përbashkët nuk do të mungojë", ka shkruar Muharremaj në llogarinë e vet në "Facebook".





# MKRS-ja dha çmimet për letërsi

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për nder të 12-vjetorit të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sot ka dhënë Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe çmimet vjetore për letërsi.

Juria profesionale për vlerësimin e çmimeve në përbërje të prof. dr. Hysen Matoshi - kryetar, Adem Zejnullahu, Faik Shkodra, Emin Emiri dhe Riza Haziri - anëtarë, kanë vendosur që çmimet të jepen për: Çmimi Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" t'i jepet Sabile Keçmezi - Basha; Çmimi për veprën më të mirë në prozë "Anton Pashku" t'u jepet Rrahman Paçarizit për romanin "Shtatë udhë" dhe Albina Idrizit për romanin "Përsëri mars"; Çmimi për veprën më të mirë në poezi "Ali Podrimja" t'u jepet Xhevdet Bajrajt për veprën "Kur qajnë hardhitë" dhe Nexhat Rexhës për veprën "Duke kërkuar hijen tënde"; Çmimi për veprën më të mirë në kritikë letrare dhe eseistikë "Ibrahim Rugova" t'i jepet Berat Dakajt (Armagedoni) për



Dumoshi.

Duke filluar nga procedurat e hapjes së konkursit e deri te ndarja e çmimeve parashihen me rregullore të veçantë të MKRS-së, e cila procedurë përfshin dhe emërimin e një jurie, e cila rekomandon laureatët e çmimeve.

"Unë si ministre e vlerësoj lart dhënien e çmimeve për letërsi, sepse besoj se duke dhënë këto çmime për çdo vit ne i kontribuojmë edhe stimulimit dhe nxitjes së krijesve të

motivacionin për punën e saj krijuese në fushën e letërsisë, për një varg veprash që shquhen për prurje të reja si në përmbajtje ideore, po ashtu edhe në format letrare.

Ndërsa për çmimet e tjera juria dha këto vlerësime: Proza "Shtatë udhë" e autorit Rrahman Paçarizi ta kujton rrëfimin biblik për krijimin e botës e të njeriut brenda një jave. Romani "Përsëri mars" i Albina Idrizit ngërthen vlera ideore, estetike dhe artistike; elemente të bollshme realiste, aktuale, madje historike. Përmbledhja poetike "Kur qajnë hardhitë" e Xhevdet Bajrajt shquhet për intonacionin e veçantë ligjërimor e estetik, për krijimin e kodeve dhe figurave poetike me një emancipim të thellë mendimor e emocional. Përmbledhja poetike "Duke kërkuar hijen tënde" e Nexhat Rexhës shpërfaq dramën e individit si reagim artistik përballë bëmave të historisë dhe të aktualitetit. Studimi monografik "Dramat e Qosjes" i Berat Dakajt (Armagedonit) ngërthen një shumësi elementesh dhe premisash të zhvillimit të dramës shqipe në kontestin historik, teoriko-letrar, ideoestetik, filozofik, antropologjik, mitologjik e socio-psikologjik. Romani autobiografik "Guaska" i Mustafa Halifas, shkrimtar sirian, është një ndër veprat lapidare që, nëpërmjet një rrëfimi të çlirët, përshkruan dhunën dhe brutalitetin e pushteteve, rrjedhojat që ia krijojnë individit të qëndruarit brenda guaskës kufizuese. Tregimet e vëllimit "Libri i përrallave të gjyshit" të Jonuz Fetahajt përshkohen me ngjarje që trajtojnë botën e brendshme të fëmijëve, dëshirat, ëndrrat, mendimet mbi jetën dhe për jetën.



studimin "Dramat e Qosjes"; Çmimi për veprën më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas "Pjetër Bogdani" t'i jepet Isa Memishit për përkthimin e romanit "Guaska" të Mustafa Halifas; dhe Çmimi për veprën më të mirë për fëmijë e të rinj "Vehbi Kikaj" t'i jepet Januz Fetahajt për veprën "Libri i përrallave të gjyshit".

Me këtë rast, në një ceremoni të organizuar në kabinetin e ministres Vlora Dumoshi, e para e MKRS-së u uroi mirëseardhje laureatëve dhe anëtarëve të jurisë.

"Në këtë ditë të shënuar kujtojmë të gjithë ata krijues që me veprat e tyre kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në krijimtarinë tonë. Jo rastësisht ndarja e çmimeve të letërsisë po bëhet sot në këtë ceremoni të organizuar nga ministria sepse, përveçse po ndajmë çmime të rëndësishme për letërsinë, kulturën dhe artin, përveçse sot po i shpërblejmë krijuesit e letërsisë, po e festojmë edhe përvjetorin e shtetësisë së Kosovës. Sot simbolikisht më takoi mua si ministre që t'i ndaj këto çmime, ndonëse të gjitha punët rreth vlerësimit të tyre i takojnë mandatit të qeverisjes së kaluar", tha ministrja



## EVROPË!, UNË E KAM FLAMURIN!

**Ylli MECE**

*I shtrëngova duart grusht  
Dhëmbët theva prej inatit  
Se jam bir i kësaj toke  
Kosovar që s'pret prej fatit*

*Nëse unë e kam flamurin  
Pse në shtizë vure një tjetër?  
Do t'më thuash se lirinë  
Ti ma fale "zuskë e vjetër"?!!*

*Unë nder shekuj vrullshëm renda  
Për At dhe...e për flamur  
Bota hiq...se nuk e dashka...  
Ata hiq.... e ne prapë vur!*

*Ky flamur më duket ndryshe  
Nuk më duhet jo për besë!  
Se pa drite ...çdo lule vyshket  
Pa një zemër...çdo komb vdes!*

*Si se njohe kurrë shqiptarin..?  
Moj Evropë ...që rri mbi letër!  
Ne Lirinë edhe Flamurin...  
Nuk e ndërrojmë me asgjë tjetër!*

*Nëse fale një flamur  
Dhe e morën pa e parë  
Sytë vallë ku i kishin?  
Se me gjak ky s'është i larë!*

*Ah moj kohë e padrejtësive  
Si me vjen kështu maskuar  
Pse ma ndan më dysh flamurin  
E pse më bën të rebeluar?*

*A e di ti moj Evropë  
Se flamurin kam At dhe?  
Nëse ti ma heq shqiponjën  
Kot që rrojmë, përmbi dhe!*

*Po të them: Mos më godit!  
Mos godit mbi gjak të rënë  
Padrejtësive shekullore  
Pse u shton një më të rendë?*

*Këtë "dhuratë" unë nuk ta dua  
Është turp, turp për besë  
Unë e kam në shpirtin tim  
Dhe në zemër do të mbesë!*

*Ndaj dhe zemra me rreh fort  
Gjakun që kalon në rremba  
Nuk ma ndal dot as me plumb  
Nuk ma lidh as tel me gjemba!*

*Ne shqiptarët që prej motit.  
Pak i pamë lulet e fushës  
S'na la tymi i barotit  
Nuk na lanë erërat e luftës.....!*





# Terrori shtetëror jugosllav ndaj krijuesve ishte i dhunshëm dhe barbar



**Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA**

- Të nderuar familjarë të shkrimtarit Azem Shkreli!

- E nderuar Ministre e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, z. Vlora Dumoshi!

- E nderuar drejtoreshë e Departamentit të Kulturës, zonja Jehona Shyti

- Të nderuar anëtarë të jurisë!

- Të nderuar miq e kolegë të pranishëm!

Sot vërtet jam shumë e nderuar që më jepet Çmimi Jetësor "Azem Shkreli", një çmim që është një më prestigjiozë letrar që jepet në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, ndihem krenare edhe për arsye se këtë çmim ma jep Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, po ashtu edhe për emrin e poetit që mban emrin "Azem Shkreli" e që, ndaj veprës së shkrimtarit, kam një vlerësim të veçantë.

Nis Peterson, poet danez, duke folur për rëndësinë e poezisë, thotë: "Mëso, se kur mungon fantazia, sundojnë vrazhdësia, egoizmi, vdekja. Mëso, se pa poezinë njeriu nuk do të ishte i aftë për ndjenja të thella si: dashuria, patriotizmi, malli ose synimi për një botë të përkryer". Andaj, shtrohet pyetja, Azem Shkreli, ishte poet, shkrimtar, humanist, tregimtar, romancier, dramaturg, apo që të gjitha i kishte me bollëk?! Duke i njohur shkrimet e njeriut të penës e të shkrimtarisë, jo vetëm në Kosovë, besoj se vepra e tij do të qëndrojë si pikë referimi për shumë gjenerata të ardhshme se nën 1: për shkak të prozës së bukur që e karakterizon; dhe, nën 2: për shkak të poezisë të konceptuar e të menduar, mbi bazën e një varg simbolesh, metaforash, me të cilat trajton dhe artikulon tema, motive, ngjarje e aspekte nga historia jonë e dhimbshme. Poezi që këndojnë momente të trishta. Ankthe të papërshkuara të njerëzve të nënqiellit tonë. Por, mbi të gjitha, do të jetoj gjatë, për

faktin se ajo rrok në mënyrë mjeshtërore thelbin e fuqisë shpirtërore, qartësinë morale, brishtësinë njerëzore dhe synimin hyjnor që karakterizonin njerëzit në Kosovë dhe në të gjitha trojet shqiptare.

*Të nderuar të pranishëm,*

I kam lexuar shumë herët veprat e shkrimtarit Azem Shkreli, por në vitet '80, thënë sinqerisht, iu kam rikthyer edhe një herë, atëherë kur poezia shqipe filloi të akuzohej dhe të diskriminohej tej mase. Por, gjithsesi duhet shtuar se poetët dhe historia e poezisë shqipe në ish-Jugosllavi mund të thuhej se ishte një ndër më tragjike në Evropë. I ashtuquajtur "realizëm socialist", si në asnjë vend tjetër të botës, e kishte shterpëzuar dhe vrarë gjysmëshekulli të kulturës sonë kombëtare. Kundër krijuesve shqiptarë ishte ushtruar një dhunë dhe një masakër e programuar dhe e padëgjuar ndonjëherë.

Dhe, poetët ishin ata, të nderuar të pranishëm, që me një gjuhë tjetër e shprehen urrejtjen ndaj robërisë dhe dashurinë e madhe ndaj lirisë. Andaj, sistemi komunist jugosllav i frikësohej tej mase zërit të poetëve, ndaj kishte vendosur ta përdorte grushtin e hekurt, duke ndërsyer

kundër tyre punëtorët e UDB-së dhe hetuesit e shumtë për t'i ndjekur ata. Në ish-Jugosllavi nuk dënoheshin vetëm poetët e shkrimtarët, por në të dënoheshin edhe veprat e tyre, madje... madje përdhosheshin edhe varret, ku preheshin eshtrat e shkrimtarëve. Terrori shtetëror ishte i dhunshëm, i tmerrshëm dhe rrëqethës. Vendi ishte kthyer në një Had të vërtetë e të llahtarshëm.

E poeti Azem Shkreli, edhe pse fliste me gjuhën e Ezopit, çdo gjë ishte e qartë për lexuesin e vëmendshëm, e nëpër këtë rrugë kishin kaluar shumë penda të ndritura të letërsisë shqipe. Po citoj vetëm 2-3 vargje të poetit nga poezia "Zjarrmia":

Tash sa kohe  
po don të gdhijë  
e s'po mundet...

Dhe, përsëri dua të shtoj, se të marrësh një çmim si ky, nga njerëz që dinë dhe çmojnë veprimtarinë time krijuese, e aq më shumë, në datëlindjen e 12-të të Pavarësisë së Kosovës, është një nder e krenari, por edhe një emocion ngazëllimi e obligimi bashkë.

*Të nderuar të pranishëm,*

Asnjëherë nuk kam punuar për çmime letrare. Kam shkruar, se e kam ndërse se duhet të shkruaj. Se njeriu në këtë botë nuk vjen

vetëm për vete, por ka edhe një mision të veçantë, se të shkruash, të botosh, të lësh diçka mbrapa, do të thotë ta sfidosh veten, rrethin dhe vdekjen.

Andaj, brenda çdo krijuesi, përveç dhuntisë artistike, ekziston edhe përvuajtja. Shkrimtari duhet ta reformojë veten si njeri, që mund të sjellë një model i cili do të të merret si sinjal i civilizimit shpirtëror. Në të gjitha kohët shkrimtarët kanë përjetuar, se të pasurit talent nuk është gjithçka. Duhet një punë shumë e madhe, shumë sakrifica, shumë vuajtje, shumë kohë, sa vetëm ai që shkruan mund ta imagjinojë tërë këtë. Edhe mua më ndodh e njëjta gjë. Sigurisht, për çdo krijues letërsia kërkon sakrifica të paimagjinueshme. Meditimi i jetës së njeriut nuk është si një film i thjeshtë të cilit i dihet fundi... por ajo vazhdon... të jetë enigmë e pazbërthyer.

Andaj, më lejoni krejt në fund, sadopak t'i bëj falënderimet e mia.

Fillimisht falënderoj propozuesit për këtë çmim: Editorin e shtëpisë botuese "Rozafa", z. Ramadan Mehmeti nga Prishtina, Klubin Letrar "Nositi" nga Dardana, z. Nexhat Rexha, të cilët më kanë propozuar për Çmimin Kombëtar Letrar "Azem Shkreli" për Vepër Jetësore.

Falënderoj jurinë e cila u përcaktua për mua, duke vlerësuar punën dhe krijimtarinë time.

Falënderoj ministren e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zonjën e nderuar Vlora Dumoshi, e cila, bashkë me stafin e saj, dëshmuar se çmojnë vlerat që janë krijuar dhe krijohen në Kosovë, në të kaluarën, në kushtet e robërisë e të censurës dhe që vazhdojnë të krijohen edhe sot në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, falënderoj familjen time, bashkëshortin Tefikun, fëmijët Artën e Agonin, që më përkrahën në çdo rrugëtim të jetës.

Dhe krejt në fund, uroj kolegët e mi, që gjithashtu janë fitues të çmimeve për veprat më të mira, nga fusha e poezisë, e prozës, e kritikës dhe e përkthimit letrar, të botuara gjatë vitit 2019, duke u dëshiruar në të ardhmen shëndet dhe suksese të reja në vitet që vijjnë.


Të gjithë juve, ju uroj Ditën e Pavarësisë dhe ju falënderoj për vëmendjen!

*(Fjalë e mbajtur në ceremoninë e dorëzimit të Çmimit Kombëtar "Azem Shkreli" në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, më 17 shkurt 2020, në Prishtinë)*





# Shprehitë kaotike të gjenit të artit



*Një ekspozitë në Londër, analizon një aspekt pak të njohur të një prej artistëve më të mëdhenj të shekullit XX, Pablo Picasso. Pjesë të shkrimit të kritikës së artit Daisy Dunn, Telegrafi sjell më poshtë*

Picasso do të kishte pak kohë për enterierët e sotëm të saktë dhe minimalistë. Ai rrethohej nga rrëmuja, duke e ditur se edhe sendet e dëmtuara e të zakonshme që njerëzit i hidhnin, do të mund të kishin interes artistik. Grumbulloi gjithçka, që nga gazetat e vjetra, mbështjellëse letrash dhe zarfe të përdorura, e deri tek kutitë e duhanit, biletat e autobusëve dhe pecetat e letrës. Kur vdiq më 1973, në moshën 91-vjeçare, kishte grumbulluar mijëra copa, një pjesë e të cilave janë shfaqur në Akademinë Mbretërore të Londrës si pjesë e një ekspozite kushtuar pasionit të tij për letrën. Treqind vepra arti dhe gjësende nga koleksioni i tij që kapin në shumë se 80 vjet, flasin sa për rrangallat aq edhe për vizionin e tij.

Studiot që Picasso i vizatoi ishin rrallë kaotike. Një nga skicat e tij përgatitore nga viti 1903, për "Jetën" – një pikturë melankolike nga Periudha e tij e Kaltër – paraqet një kanavacë të pozicionuar si duhet në këmbalec. "Studioja e skulptorit" nga viti 1931 është mjaft e rregullt. Por, fotografitë zbulojnë pamje tjetër: Picasso e pëlqente parregullsinë. Studioja e tij në Kanë ishte e mbushur me gjësende – topa letrë, kuti dhe kavanoza ngjyrash që mbushnin çdo sipërfaqe, madje edhe karriget.

"Picasso njëherë tha: 'Je çfarë ruan'", thotë Ann Dumas, bashkëkuratore e ekspozitës "Picasso dhe letra". "Ishte shumë i vetëdijshëm për mbajtjen dhe regjistrimin e gjërave".

I merrte gazetat dhe u përgjigjej historive të tyre duke i vizatuar me laps ose ngjyrë. Kishte pak vende ku nuk do të shkarraviste. Nëse një fletë paketimi ishte e mbuluar me ndonjë model ngjyrash ose tekst, do të vizatonte sipër; puna e tij shkrihej me shtypin derisa të dya bëheshin mezi të dallueshme. Efekti mund të jetë shpesh komik, sikur kur e merr stilolapsin e punon te një fotografi e modeles së revistës "Vogue" duke ia zgjatur këmbët për të dalë në mënyrë

joshëse nga fustani i balos.

Pasi për shumë artistë kaosi nënkuptonte kreativitet, grumbujt e Picassos ishin objekte të përsosura me të cilat gjallëronte natyrat e tij të vdekura. Miku i tij, artisti Georges Braque, cilësohet si shpikës i kolazhit modern, por Picasso ishte i shpejtë të kapte çdo formë arti. Atë vit e përfundoi "Natyren e vdekur në ulësen e karriges", duke përdorur një cohë për ulëse të karriges. Gjenialiteti i tij ishte në gjetjen e objektit të duhur

jetës së përditshme. Askush nuk do të harrojë thonjtë e vjetër, copat e rrobave dhe telat që futi në pikturat e tij të kitarave. Picasso madje krijoi një kitarë nga kartoni, në tri dimensione.

Për shumë artistë, letra ishte thjesht një medium përgatitor, një bazë mbi të cilën shtohen idetë para se të përkthehen në kanavacë ose në bronz. Për Picasson, letra nuk ishte veç për skicim. Me veprën "Gratë në tualetin e tyre" (1937-8) demonstroi sesa efektiv



**Rikrijimi i vepërs së Manetit (1962)**



**Picasso në studion e tij në Kanë**


për secilën hapësirë dhe në ruajtjen e formës teksa ngatërrohte planin e pikturës. Në vitin 1914, pakoja e duhanit dhe gazeta ishin ndër materialet që përdori për të krijuar kolazhin "Qelqi, shishja e verës, pakoja e duhanit, gazeta". Shumë kohë para se riciklimi të ishte shqetësim mjedisor, Picasso tregoi se ka bukuri te mbeturinat e

mund të ishte kolazhi. Më vonë analizoi veprën "Dreka në bar" (1863) nga Edouard Manet dhe rikrijoi figurat e tij duke i hequr nga të gjitha zbukurimet dhe duke i transferuar nga kanavaca në karton. Njerëzit e tij të letrave, nga fillimi i viteve 1960, duket se rebelohen kundër pararendësve në pikturë.

Picasso ishte gjithnjë i shkathët. Printimet e tij më të hershme që kanë mbijetuar, si "Matadori që shihet nga pas" (1900), u bë duke gdhendur dhe ngrohur bazën e një tasi druri. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shkathhtësia ishte domosdoshmëri, ndaj Picasso priste, shqyente dhe digjte letrat në forma të reja. Materialet vështirë arrinin në Paris gjatë okupimit gjerman, por Picasso nga mbetjet në depon e tij bënte thikë e piru, një dhi, një zog, një dorezë, një varg

valltarësh dhe kryesorja, serinë e kafkave të cilat gjithashtu i pikturoi. Një pecetë letrë e djegur shërbeu për ta përfaqësuar qenushin e ngordhur të të dashurës së tij, Dora Maar. Nuk ishte rastësi që shumë nga këto forma të kohës së luftës, u ngjanin fantazmave.

Grumbujt që Picasso la pas dokumentojnë ekzistencën e tij të përditshme. Ato janë mendimet, g j y s m ë - m e n d i m e t , shpërqendrimet nga të cilat u rritën shumë ide të tij. /Telegrafi/




**"Gruaja e ulur" (Dora, 1938)**



**"Koka e gruas" (1962)**



**"Violina" (1912) e punuar nga materialet e grumbulluara**




**Autoportret (1918) me laps dhe qymyr**



**E rrallë**

## Para 109 vjetësh u realizua fluturimi i parë me aeroplan postar

Para 109 vjetësh është realizuar fluturimi i parë zyrtar me një aeroplan postar. Fluturimi i parë u bë nga Allahabad në Provincat e Bashkuara të Indisë Britanike në Naini, ose rreth 10 kilometra nga pika e nisjes. Më 18 shkurt 1911 ishte 23-vjeçari Henri Pequet që pilotoi avionin që mbante 6 500 letra. Ai drejtoi një Humber-Sommer me rreth pesëdhjetë



kuaj fuqi dhe udhëtimi i tij zgjati rreth 13 minuta. Letrat ishin të shënuara "Posta e Parë Ajrore, Allahabad 1911".

**FOTO E DITES**



Një grua e moshuar e shpërngulur siriane mbart një fëmijë në kampin Washukanni, në afërsi të qytetit me shumicë kurde Hasakeh në verilindje të Sirisë. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## I plotësuan certifikatën e vdekjes, zemra e foshnjës rreh sërish

Një foshnjë që u shpall tri herë pa jetë nga mjekët u gjet duke marrë frymë brenda arkivolit nga prindërit. Foshnja mendohet se kishte vdekur gjatë lindjes së parakohshme në javën e 27-të të shtatzënisë, pa hyrë ende në muajin e shtatë, shkruajnë mediat e huaja. Por prindërit mbetën të shokuar kur zbuluan se ai ende po merrte



frymë disa orë më vonë. Ngjarja ka ndodhur në Santa Cruz, në Bolivinë Lindore. Autoritetet policore në Bolivi janë duke hetuar në lidhje me ngjarjen dhe po e trajtojnë çështjen si rezultat i një pakujdesie mjekësore, megjithëse mjekët pretendojnë se ky rast është një "mrekulli".

**BARSOLETA E DITËS**



**Nëna e lëvdon vajzën para burrit potencial.**  
- Ajo përgatit ushqimin për mrekulli. Është magjike në kuzhinë. Zemër, a e pastrove sallatën?  
- Jo, ende. Nuk kishte detergent.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00**  
**Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



**Në ora 18:00**  
**Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

**STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

**THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Për ta përbulluar një kohë të vështirë financiare kontaktoni personin e duhur. Në punë është e mundur të gjesht zgjidhje për problemet aktuale.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do të keni doza masive origjinaliteti, dinamizmi dhe shumë shkathtësi. Topi është në duart tuaja, luani mirë, me guxim, aftësi dhe vendosmëri.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Pritet një ditë me të vërtetë e kënaqshme, nëse duhet të udhëtoni apo të studioni. Qielli do t'ju mbështesë që të keni një mendje të qartë dhe vendime të një rëndësie të caktuar.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Dihet që ju përpqeni ta mashtroni veten për emocionet që ndjeni, por rezultati në fund është se e humbni komplet busullën tuaj.</p>	 <p><b>LUANI</b> Në punë gjëja e rëndësishme është të keni edhe një qëllim dhe ta çoni deri në fund. Në dashuri, nëse ndjenja juaj kthehet, do të keni shanse të shkëlqyera për të marrë më shumë sesa keni shpresuar ndonjëherë.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Nervozizmi juaj do të rritet. Për momentin reflekset tuaja janë mjaft të dëmtuara, mos e mbingarkoni veten me shumë angazhime!</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Faji nuk është vetëm i juaji, por edhe i Hënës joharmonike në shenjë tënde. Mos u dorëzoni. Nëse pengoheni, çohuni! Kontrolloni nervozizmin tuaj duke pirë një çaj bimor me balsam limoni.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Për ata që kërkojnë një punë të re, vijë lajme të mira, por vetëm nëse kartat tuaja janë më shumë sesa në rregull.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Do të keni një ditë të mbushur me ide dhe projekte që do t'ju sjellin një kënaqësi të madhe, gjithashtu edhe nga këndvështrimi financiar.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Yjet do t'ju ndihmojnë t'i demonstroi cilësitë tuaja dhe të arrini qëllime vërtet ambicioze. Përbalë një zgjedhje, një vendim të rëndësishëm biznesi, ju do të dini se si të veproni.</p>	 <p><b>UJORI</b> Do të filloni kërkime të reja në gjërat shpirtërore, do ta zhvilloni talentin për muzikë dhe art. Në çështjet praktike, kini kujdes nga shpërqendrimi i cili mund t'ju kushtojë gabime dhe humbje të energjisë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Prijet tuaja, nën ndikimin e yjeve, janë gjithnjë e më të qarta dhe ju çojnë në një rrugë të drejtë. Situatat interesante priten për ata që janë të vetëpunësuar, veçanërisht nëse ata operojnë në sektorin tregtar.</p>



## Ronaldo i jep çdo muaj 100 mijë euro Georginës



**C**ristiano Ronaldo dhe Georgina Rodrigues janë një nga çiftet më të komentuar të momentit. Ata janë njohur katër vjet më parë kur Georgina ishte shitëse në një dyqan të Guçit në Madrid. Modeluesja ka vendosur që të mos merret me asgjë për momentin dhe të kujdeset për

fëmijët e tyre në shtëpinë luksoze. Televizioni spanjoll "Telecinco" ka zbuluar se Cristiano Ronaldo i jep një shumë të madhe Georginës muaj për muaj për shpenzimet e saj dhe për fëmijët e tyre. Sipas këtij televizioni, shuma që Georgina merr nga Ronaldo shkon rreth 50 000 deri në 100 000 euro.

## Adele paralajmëron lansimin e albumit në shtator



**K**ëngëtarja me famë botërore, Adele, pritet që ta lansojë albumin më të ri në shtator sipas një videoje të publikuar në rrjetet sociale. Albumin e fundit Adele e solli në vitin 2015. Në video Adele shihet se ka pasur ndejë private dhe në një moment të mbrëmjes ajo u ka

thënë mysafirëve të 'presin për albumin e ri në shtator'. Kujtojmë se britanikja së fundmi është komentuar edhe për ndryshimin drastik që ka bërë në dukje. U raportua se Adele i ka humbur 45 kilogramë si rezultat i dietës rigorozë që e ka kombinuar edhe me aktivitete fizike.



## Kate Middleton flet për mëmësinë dhe fëmijërinë e saj

Prej momentit që u bë pjesë e familjes mbretërore, Kate Middleton ka dhënë shumë pak intervista. Së fundmi ajo është treguar e hapur të flasë për më shumë se 30 minuta në një intervistë të singertë për mëmësinë, fëmijërinë e saj dhe pasionet e saj të hershme. Kate u shfaq në një episod special të Giovanna Fletcher, "Happy Mum, Happy Baby". Dukësja foli hapur për rolin e saj si nënë e tre fëmijëve, Georgeit, Charlottes dhe Louisit. Kate Middleton ka treguar edhe një foto të vogëlushes së saj, Charlotte, duke

mbledhur lule. Ajo shpjegon rëndësinë e të qenit në natyrë në ajër të pastër. Kate rrëfeu për gjyshen e saj, edukimin që dëshiron t'ua përcjellë fëmijëve dhe dashurinë për të kaluar kohë jashtë. "Unë kisha një gjyshe të mrekullueshme e cila na kushtoi shumë kohë. Luante me ne, bënte art dhe punime dore, na çonte në serra, gatuante me ne. Prandaj unë përpiqem të përfshij shumë nga aktivitetet që ajo bënte me ne, në kohën që kaloj me fëmijët e mi", ka thënë Kate.

## Elton John humb zërin në koncert



**S**ir Elton John është detyruar ta ndërpresë koncertin në Zelandën e Re pasi u sëmurë nga pneumonia. Muzikanti 72-vjeçar humbi zërin në mes të koncertit në Mount Smart Stadium të Aucklandit të dielën. "Unë kam humbur plotësisht zërin tim. Nuk mund të këndoj", i tha Eltoni tur-

mës. "Unë kam për të shkuar. Më vjen keq", ka thënë ai. Elton John ka shpërthyer në lot duke u mbështetur në piano dhe tundi kokën. Publiku ka duartrokatur këngëtarin anglez dhe i ka dhënë mbështetjen e madhe, ndërkohë që ai po largohej nga skena me ndihmën e disa asistentëve.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Gjysmëfinale të 'zjarrta' për Kupë

Shoti i Kupës në gjysmëfinale ka sjellë përballjen në mes të kampionit vjeshtor, Ballkanit dhe kampionit dhe fituesit të Kupës në edicionin e kaluar, Feronikelit. Në gjysmëfinalen e dytë takohen Prishtina dhe Drenica. Ndeshjet e para zhvillohen më 8 prill, ato të kthimit më 22 prill



FOTO: ARKIV

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 18 SHKURT - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) të martën është bërë tërheqja e shortit për ndeshjet gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës. Në tërheqje të shortit, krahas anëtarëve të Komisionit të Garave, ishte edhe sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu, i cili i përshëndeti përfaqësuesit e klubeve pjesëmarrëse në këtë fazë të garave duke iu uruar fat dhe suksese. Në gjysmëfinale do të takohen: Prishtina - Drenica dhe Ballkani - Feronikeli. Drejtori sportiv i Ballkanit, Arben

Osmani, ka thënë se përballja me "Niklin" do të jetë shumë interesante, kurse Ballkani do të mundohet që me të gjitha forcat ta sjellin Kupën në Suharekë. "Feronikeli është fitues i Kupës, por ne do të bëjmë çmos që atë ta sjellim në Suharekë, duke kaluar së pari Feronikelin e më pas kundërshtarin e radhës që do të na bie. Është mirë të luajmë me 'Niklin', është skuadër cilësore, kushtet janë të mira në Drenas, kështu që besoj se do të shfaqim futboll të mirë e pastaj janë 180 minutat dhe mundësia për korrigjim", ka thënë Osmani, drejtor sportiv i Ballkanit.

Për ndeshjen gjysmëfinale ndaj

Ballkanit ka folur sulmuesi i skuadrës nga Drenasi, Mevlan Zeka, i cili e ka quajtur përballje finale para finales. "Duke e parë ecurinë e mirë të Ballkanit nuk do të jetë e lehtë ndaj tij, por Kupa është një garë krejtësisht ndryshe. Ballkani ka një skuadër shumë të organizuar mirë në të gjitha repartet dhe një trajner motivues. Por, unë mendoj se kjo përballje do të jetë një finale para finales. Feronikeli do t'u qaset maksimalisht dy takimeve sepse e dimë çfarë do të thotë gara e Kupës", ka thënë Zeka.

Ndeshjet e para gjysmëfinale do të zhvillohen më 8 prill, ato të kthimit më 22 prill.

## SHKURT

### FBK-ja: Në Pallatin e Rinisë stërviten vetëm Kosova dhe Islanda

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se të mërkurën dhe të enjten në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë do të stërvitin vetëm Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll dhe ajo e Islandës. "Kjo vjen për shkak të rregullave të FIBA-s që nuk lejon klubet e tjera të stërvitin për shkak të ndeshjes zyrtare ndërmjet Kosovës dhe Islandës që zhvillohet të enjten nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë", thuhet në njoftimin e FBK-së. Federata e Basketbollit ka kërkuar mirëkuptim nga klubet e Prishtinës që stërvitin në Pallatin e Rinisë dhe Sportit.

### Rashica do të jetë zëvendësues i Sanchos në Dortmund

Reprezentuesi i Kosovës, Milot Rashica, mund të transferohet te Borussia Dortmund si zëvendësues i Jadon Sanchon, raporton gazeta gjermane "Deichstube". Sancho është përfolur se do të largohet nga Dortmundi gjatë afatit kalimtar të verës. Për këtë arsye, Dortmundi ka filluar të kërkojë për një zëvendësues potencial dhe Milot Rashica është identifikuar si opsioni më i përsosur për anglezin. Rashica ka kontratë me Werderin deri në vitin 2022, kurse i ka bërë 21 paraqitje këtë sezon dhe ka shënuar dhjetë gola dhe dhënë katër asistime.

### Filloi kursi i dytë për Licencën C në regjionin e Prishtinës

Sektori për edukim në Federatën e Futbollit të Kosovës të martën ka nisur kursin e dytë të trajnerëve për Licencën C për Regjionin e Prishtinës. Në këtë kurs po marrin pjesë 24 kandidatë, të cilët do të punojnë në teori dhe praktikë në 10 ditë kalendarike përgjatë këtij muaji dhe muajit mars, derisa në fund do t'i nënshtrohen provimit për t'u pajisur me Licencën C. Krahas aspektit teorik, pjesëmarrësit për disa orë kanë punuar edhe në aspektin praktik në fushën e KF "Rilindja". Kurse të tilla do të mbahen edhe në regjionet e tjera, ku për muajin prill është paraparë të mbahet kursi në regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit.

## Kastrati: Luajmë për fitore ndaj Islandës dhe Luksemburgut

PRISHTINË, 18 SHKURT - Basketbollistët e Përfaqësueses së Kosovës i kanë vazhduar përgatitjet edhe të martën për dy ndeshjet parakualifikuese për

Kampionatin Botëror 2023. "Dardanët" ndeshjen e parë e zhvillojnë ndaj Islandës më 20 shkurt, kurse tri ditë më vonë përballen me Luksemburgun. Basketbollisti Erjon Kastrati

ka thënë se të gjithë do ta japin maksimumin për t'i fituar këto dy ndeshje. "Fillimisht dua të them se kam nderin dhe kënaqësinë që jam i ftuar në

Përfaqësuesen e Kosovës. Siç ka thënë trajneri, duhet të përpiqemi të fitojmë në çdo ndeshje. Do të japim më të mirën nga vetja jonë në këto ndeshje", ka thënë Kastrati.





## Rosbergu, Vettelit: Ja se si mund ta mposhtësh Hamiltonin

**BERLIN, 18 SHKURT** - Sebastian Vetteli ende nuk ka rinovuar kontratën me Ferrarin, e cila skadon në fund të këtij viti. Për ta arritur këtë gjë, piloti gjerman ka nevojë për ta marrë besimin e Ferrarit, që për momentin i beson vetëm

Charles Leclerc, të cilit ia ka rinovuar kontratën. Nico Rosberg, ish-kampion bote në Formula 1 dhe ish-shok skuadre me Lewis Hamiltonin te Mercedesi, i jep një këshillë patriotit të tij se si të rikthehet në nivelin e dikurshëm. "Situata

e Vettelit nuk është e thjeshtë. Leclerc e ka fituar besimin e skuadrës dhe mori rinovimin deri në vitin 2021", ka thënë Rosberg. "Këtë gjë duhet të bëjë edhe Vetteli, ta fitojë besimin e skuadrës. Për fat të keq, sezonet e fundit ka zhgënjyer, ndaj

është krijuar kjo situatë. Hamiltoni fiton pasi ka besimin e gjithë ekipit, ndaj dhe Vetteli duhet ta fitojë besimin e gjithë skuadrës që ta mbështesë. Garat e para do të jenë thelbësore për t'ia dalë mbanë", ka deklaruar Rosbergu.



## Sonte përballen Tottenham - Leipzig dhe Atalanta - Valencia

Londër, 18 shkurt - Liga e Kampionëve do të vazhdojë sonte (e mërkurë) me dy ndeshjet e radhës, të cilat pritet të jenë interesante. Nënkampionia e Evropës, Tottenham Hotspur, e pret skuadrën e Bundesligës, RB Leipzig. "Spurs" përfundoi në pozitën e dytë në Grupin B pas Bayern Munchenit. Leipzig kryesoi Grupin G për të arritur në këtë fazë për herë të parë. Paraqitjet e djelmohave që drejtohen nga Jose Mourinho nuk kanë qenë aq bindëse, por Tottenhami ka arritur tri fitore dhe në shtatë ndeshje është pa humbje në të gjitha garat. Portugezi Mourinho është sjellë në klub për t'i rikthyer rezultatet pozitive, ani pse ngadalë Mourinho po arrin të bëjë një gjë të tillë. Diferenca në mes të skuadrave kryesuese, përjashto Liverpoolin, është e vogël. Në anën tjetër, në formë të mirë është edhe Leipzigu që po e mban Bayernin në presion për



titull në Gjermani. Vendësit në këtë ndeshje do të jenë pa Harry Kane, Heung-Min Son dhe Moussa Sissoko, por të gatshëm janë Juan Foyth dhe Erik Lamela. Kthimi i Ben Davies pas tre muajsh është një tjetër lajm pozitiv për Mourinhon. Te mysafirët mungojnë Willi Orban dhe Ibrahim Konate për shkak të lëndimit, kurse Dayot Upamecano nuk ka të drejtë loje për shkak të kartonëve. Tyler Adams dhe Kevin Kampl janë dy mungesat e tjera të konfirmuara të Leipzigit. Në ndeshjen tjetër të 16 klubeve më të mira në

garën më të fortë në futboll do të takohen në Itali, Atalanta dhe Valencia. Atalanta aktualisht është në pozitën e katërt në Serinë A, kurse Valencia e gjen veten në vendin e shtatë në La Liga. Valencia në këtë ndeshje do të jetë pa mbrojtësit me përvojë Gabriel Paulista dhe Ezequiel Garay që mungojnë për shkak të lëndimit dhe pezullimit, derisa në dyshim janë edhe mesfushorët Francis Coquelin dhe Rodrigo Moreno. Në anën tjetër Atalanta e Berat Gjimshit nuk ka probleme me lëndime apo suspendime.

**Të mërkurën takohen:**  
21:00 Atalanta - Valencia  
21:00 Tottenham H. - Leipzig

## Fillon shitja e biletave për ndeshjen Kosovë - Islandë

**PRISHTINË, 18 SHKURT** - Të martën ka filluar shitja e biletave për ndeshjen mes ekipit përfaqësues të Kosovës në basketboll dhe Islandës, e cila është ndeshje parakualifikuese për Botërorin 2023. Kosovën e pret përballja me Islandën në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë më 20 shkurt në orën 19:00, para ndeshjes të 23 shkurtit si mysafire kundër Luksemburgut. Këto dy ndeshje të muajit mars janë të vlefshme për Grupin B të fazës parakualifikuese për Botërorin 2023, ku garon edhe Kombëtarja e Sllovakisë. Për ta përcjellë përballjen në mes të Kosovës dhe Islandës në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, të gjithë tifozët e interesuar mund të blejnë biletat, në çmim prej 2 eurosh. Biletat të martën janë shitur te



"Newborni" në Prishtinë prej orës 12:00 deri në orën 18:00. Të mërkurën shiten te palestra në Rahovec prej orës 12:00 deri në 14:00 dhe te Shatërvani në Prizren prej orës 15:00 deri në

orën 18:00. Ndërsa, të enjten shiten te "Hotel Dukagjini" në Pejë prej orës 11:00 deri në orën 15:00 dhe në shesh të Mitrovicës prej orës 15:00 deri në orën 17:00.

### SHKURT

#### Giuffredi: Ancelotti e shkatërroi Hysajin

Mario Giuffredi ka thënë se Elseid Hysaj nuk është në formën e tij të mëparshme te Napoli për shkak të vendimeve të Carlo Ancelottit. Agjenti i mbrojtësit shqiptar e ka fajësuar trajnerin aktual të Evertonit se ka ndikuar për të keq në formën e lojtarit. "Ancelotti e ka shkatërruar vetëbesimin e Elseidit (Hysajt). Ai ia ka marrë të gjithë besimin që e kishte në vete. Ai nuk bëri asgjë te Napoli, andaj edhe u shkarkua. Nuk preferoj të flas për raportin e lojtarëve me trajnerin, por shumë lojtarë janë ndikuar për të keq nga Ancelotti", ka thënë Giuffredi.

#### Lëndimi i Sonit, lajm i keq për Tottenhamin

Jose Mourinho ka marrë një lajm jo të mirë pas fitores kundër Aston Villas. Sulmuesi Heung-Min Son ka pësuar një frakturë dhe do të mungojë për disa javë, sikurse ka njoftuar klubi londinez. "Heung-Min Son do t'i nënshtrohet një operacioni këtë javë, pasi ka pasuar një frakturë në krahun e djathtë. Lojtari i Koresë së Jugut pësoi një lëndim gjatë fitores sonë kundër Aston Villës të dielën. Pas operimit, stafi ynë mjekësor do t'i shikojë opsionet për rehabilitimin e Sonit, i cili do të qëndrojë jashtë për disa javë", thuhet në komunikatën e Tottenhamit.

#### Icardi mund të përfundojë në Real

PSG-ja nuk ka vendosur ende përfundimisht ta blejë kartonin e sulmuesit argjentinas Mauro Icardi. Ky i fundit ishte personazhi kryesor gjatë periudhës ku në Paris mungonin Neymari dhe Cavani, të dëmtuar. Pikërisht në momentin më të rëndësishëm të sezonit, Icardi po humbet shumë nga shkëlqimi dhe nga kontakti me golat, kjo ka bërë që drejtuesit e klubit francez të hezitojnë për ta blerë kartonin e tij nga Interi. Për Icardin vijon të jetë e hapur pista Juve, skuadër që e kërkoi edhe gjatë verës së shkuar por, sipas "Diario Gol", në garë për t'i siguruar shërbimet e tij është futur edhe Real Madridi.

#### Katër klube në garë për Upamecanon

Dayot Upamecano është një nga lojtarët e rinj më të kërkuar sa i përket repartit të mbrojtjes. Lojtari i Leipzigit ndiqet nga ekipet më të mira të Evropës, mes të cilave Manchester City, Barcelona, Bayern Muncheni apo Arsenal. Diçka të tillë e ka konfirmuar vetë 21-vjeçari francez, duke i hapur rrugë një largimi nga gjermanët në fund të këtij sezoni. Megjithatë, mbrojtësi është treguar i kujdesshëm, duke deklaruar se për momentin është i përqendruar vetëm te klubi i tij aktual dhe se nuk mendon aspak për afatin kalimtar. Upamecano u transferua te Leipzig në janar të vitit 2017 nga austriakët e Salzburgut për shifrën e pesë milionë eurove. Ai ka një kontratë deri në qershor 2021 me klubin nga Bundesliga.

#### Wenger: City m'i bleu të gjithë lojtarët, meritoj dënimin

Arsene Wenger, në kohën kur drejtonte Arsenalin, ishte ndër të parët që e denoncoi "dopingun financiar" të futbollit. E parashikueshme edhe përgjigjja e tij pas pezullimit të Manchester Cityt nga kompeticionet e UEFA-s për dy sezone pas gjetjes së shkeljeve në rregullat e "fair play-t financiar". "Kur isha tek Arsenal m'i blenë të gjithë lojtarët. Rregullat janë dhe duhen respektuar. Kush nuk i respekton dhe tenton që të gjejë një mënyrë më pak ligjore, duhet të ndëshkohet. Nuk di të them nëse dënimi është shumë apo pak i rëndë. E sigurt është se kush e ka marrë një vendim të tillë, nuk e ka shpikur atë. Kur merr pjesë në një kom-peticion, është e rëndësishme që t'i respektohet rregullat. Nëse nuk ka respekt për rregullat, atëherë nuk është sport i vërtetë", ka shtuar strategu francez. Wenger ishte i pafuqishëm për ta penguar joshjen e Adebayorit, Sagnas, Clichyt, Toures dhe Nasrit drejt "Etihad" gjatë kohës së tij në stolin e "Topçinjve".





Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/143

Më: 18.02.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS)Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë:20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

**KONKURS**

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Naim Frashëri" në Banjë	Mësimdhënës i lëndës së Biologjisë	i lirë	1	18

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomati e kualifikimit(ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Certifikata e lindjes

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të lëndës së biologjisë kërkohet kualifikimet: **Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; Bachelor ( katërvjeçar 240 ECTS)**. Ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018, datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente( jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

**SQARIM:** Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomati e nostrifikuara në MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë, orari i intervistave, rezultatet e testit me shkrim, njoftimin për intervistën me gojë dhe vendimin për përzgjedhjen e kandidatit fitues do të publikohen në ueb- faqen e Komunitet të Malishevës dhe tabelën e shpalljeve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **18.02.2020 deri më datën: 03.03.2020.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunitet të Malishevës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave /  
Ministry of Internal Affairs and Public Administration



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Në pajtim me Ligjin e punës Nr. 03/L-212 kreu II, neni 8, Ligjin për Policinë Nr. 04/L-076, kreu V, Neni 44 i këtij ligji, Udhëzimin Administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, Kreu III, Neni 5, paragrafi 2/2, Policia e Kosovës:

U skladu sa Zakonom Rada Br. 03/L-212 poglavlje II, član 8, Zakona o Policiji Br. 04/L-076, poglavlje V, Član 44 ovog Zakona, Administrativnim Uputstvom 02/2018 o radnom odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 5, stav 2/2, Policija Kosova:

**VAZHDON AFATIN E KONKURSIT**

Referenca: 07/1-01SAP-R /13/20

Policia e Kosoves vazhdon afatin e konkursit edhe për shtatë (7) ditë për pozitën:

1. Teknik medicinal (katër vende të lira pune)

Ky konkurs vazhdohet nga data **18.02.2020** deri me **24.02.2020** për shkak të mosarritjes të një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik.

Për çdo informacion mund të kontaktoni Sektorin e Rekrutimit dhe Seleksionimit, nr. tel. 038 245184

**PRODUŽUJE ROK KONKURSA**

Referencija: 07/1-01SAP-R /13/20

Policija Kosova produžuje rok konkursa za još sedam (7) dana za položaj:

1. Medicinski tehničar (četiri slobodna radna mesta)

Ovaj konkurs se produžuje od **18.02.2020** do **24.02.2020** zato što nije postignut balansirani broj aplikacija na etničkom aspektu.

Za svaku informaciju možete kontaktirati Sektor Rekrutacije i Selekcije na broj tel. 038 245184

RESTAURANT

---

**SWISS**

TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156    +386 49 848 553

PRISHTINË

**GJEJ PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 6 para 1 pika 1.2, nenit 8 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr-463-48346 të datës 19.07.2019, Vendimit të Kuvendit të komunës 15Nr.463-48439 të datës 19.07.2019 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët dhe Vendimit të Kuvendit të komunës Nr.15-020-73228 të datës 20.12.2019 për zëvendësimin e anëtarëve të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Gadime e Ulët, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

#### NJOFTIM PUBLIK

#### PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Komuna e Lipjanit, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48346 të datës 19.07.2019 dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48439 të datës 19.07.2019, i jep në shfrytëzim në afat prej gjashtëmbëdhjetë (16-të) viteve pronat e paluajtshme të Komunës të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Gadime e Ulët, siç përcaktohen në tabelën në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura -klasa	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
1	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01048-0	Gadime e Ulët		5801
2	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-6	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	50000

Dhënia e pronave të cekura më lartë jepen me qëllim të shfrytëzimit të shkëmbinjve-seperimin të gurëve apo të ngjashëm, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro), për çdo parcelë kadastrale të ofertuar ndërsa për secilën parcelë nevojitet pliko ose zarfë e veçantë, dhe jashtë kuvertës në njëren anë duhet të shënohet ----Zona Kadastrale, Gadime e Ulët-----.

Njoftohen aplikuesit, se hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 05.03.2020 duke filluar në ora 10:00 .

#### Kriteret për zgjedhjen e ofertave

Zgjedhja e ofertës bazohet në kriteret vijuese:

- Projekti tekniko-investiv, programi i propozuar për shfrytëzimi, është i bazuar në praktikën më të mirë të shfrytëzimit dhe mbrojtjes së mjedisit në pajtim me legjislacionin në fuqi
- Vlera e investimit për periudhën për të cilën aplikon
- Numri i të punësuarve nga investimi
- Lloji i investimit që është me interes për Komunën
- Interesi financiar i Komunës
- Kompania duhet të ketë licencën e shfrytëzimit, për secilën pronë-parcelat për të cilat konkuron-aplikon, sipas kriterëve të përcaktuar në Ligjin për Miniera dhe Minerale
- Rruga deri në punishte të asfaltohet dhe të mirëmbahet me qëllim të ruajtjes së ambientit
- Pesha e automjeteve transportuese-kamionëve në rrugët lokale duhet të jetë sipas kufizimeve të përcaktuara.

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohej e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij konkursi, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vuloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar.

Kuverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

#### Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit për Njoftimin publik

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.2 në formë fizike, dhe në formë elektronike nga Ëebfaqja e Komunës .

**Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi.**

**Ofertat të pakompletuara të paprecizuara, të panëshkruara nuk do të shqyrtohen.**

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruarit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Ëebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i dytë - zyrë Nr.106 dhe 107 Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

Nr. 1-463-9888

Me datë: 18.02.2020

Kryesuesi i Komisionit

Bekim Shabani



Page 3 of 3

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





Universiteti "Ukshin Hoti"  
University "Ukshin Hoti"

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 18.02.2020	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-55

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren shpallë:

### KONKURS I BRENDSHËM

#### 1. Zyra për Marrëdhënie me Jashtë

<b>Titulli i pozitës së punës:</b>	<b>Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë PBS/170</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Pozitë e karrierës</b>
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	<b>Pa afat</b>
<b>Numri i pozitave :</b>	<b>1 (një)</b>
<b>Kategoria funksionale:</b>	<b>Nivel drejtues</b>
<b>Grada e vendit të punës:</b>	<b>6 (gjashtë)</b>
<b>Koeficienti - kod i pagës:</b>	<b>UNI 31</b>
<b>Puna provuese :</b>	<b>Pa punë provuese</b>
<b>Orari i punës:</b>	<b>Normë e plotë (40 orë në javë)</b>

Nëpunësi mbikëqyrës: Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit.

**Qëllimi i pozitës:** Zhvillimi dhe avancimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve me jashtë, hartimi, mbështetja dhe zbatimi i marrëveshjeve të Universitetit me Universitete dhe institucione tjera si dhe mbështetja e menaxhmentit të lartë në realizimin e politikave të Universitetit në çështjet e këtij divizioni.

#### Detyrat kryesore:

- Siguron zbatimin e Planit Strategjik të Universitetit për ndërkombëtarizimin e Universitetit si dhe jep mbështetjen e nevojshme profesionale menaxhmentit (Prorektorit për marrëdhënie me jashtë) për realizimin e këtij plani 20%.
- Në cilësinë e udhëheqës të zyrës jep këshilla dhe rekomandime profesionale për menaxhmentin e Universitetit si dhe ndihmon në hartimin dhe realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare 15%.
- Menaxhon punët e zyrës duke komunikuar me institucionet me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi me karakter ndërkombëtar dhe kujdeset për zbatimin dhe zgjerimin e këtyre marrëveshjeve 15%.
- Në koordinim me zyrën për informim kujdeset për versionin në gjuhën angleze të faqes zyrtare dhe gjithë dokumentacionit Zyrtar të Universitetit duke promovuar vazhdueshëm Universitetin në nivelin ndërkombëtar 15%.
- Në bashkëpunim me zyrat përkatëse të Universitetit, iu ofron të gjithë mbështetjen e nevojshme; zyrës për projekte, zyrës për mobilitet të studentëve, stafit si dhe zyrave tjera për punë të ngjashme 10%.
- Organizon dhe aranzhon takimet me karakter ndërkombëtar të Rektorit dhe menaxhmentit të Universitetit, si dhe ndihmon në organizimin e konferencave shkencore ndërkombëtare brenda dhe jashtë Universitetit 10%.
- Siguron me ndihmën edhe të stafit vartës përkthimin verbal dhe të shkruar në gjuhët jo zyrtare të Republikës së Kosovës sipas rastit dhe nevojave të Universitetit 10%.
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe e përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara; Kryen punë të tjera të ngjashme sipas kërkesës së menaxhmentit dhe nevojave të Universitetit 5%.

#### Shkathtësitë e kërkuara:

- **Kushtet:** Diploma universitare, Shkenca Politike, Ekonomik, Juridik ose Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, minimumi 5 (pesë) vite përvojë pune profesionale; njohja e gjuhës angleze në nivel të avancuar.
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim në gjuhën angleze;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet).

#### Dokumentet:

- Formulari për aplikim,
- Diploma (kopja e vërtetuar te noteri),
- Dëshmitë për përvojën e punës (profesionale),
- CV-në (biografinë),
- Çertifikatën e lindjes,
- Letërnyftimin (kopje),
- Çertifikatën penale (dëshminë që nuk jeni nën hetime).

**Informatat e përgjithshme:** Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit, duke filluar nga data: 18.02.2020 deri më: 26.02.2020 ora 16:00 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet jo të kompletuara refuzohen.

Nëpunësit civil pranohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës së përzgjedhjes së përcaktuar në bazë të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkojnë për pozitën përkatëse. Universiteti ofron mundësi të barabarta për të gjithë në përputhje të nenit 16 pika 2 të Rregullores nr.02/2010. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë femërore dhe mashkullore nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.**

**Komunitetet jo-shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, par.3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.**

#### Vëmendje:

Instrukcione për aplikim: Kërkesa (aplikacioni) për punësim mund të merren në lokalet e Universitetit ose të tërhiqen nga faqja e internetit (web faqe): www.uni-prizren.com , ku është bërë shpallja e konkursit dhe të njëjtit duhet të dorëzohen, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, në Zyrën nr. 526 në adresën: Rr. "Shkronjave" nr. 1, 20000 Prizren, çdo ditë pune nga 08:00 – 16:00.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren  
REKTORATI

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 18.02.2020	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-551A

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Na osnovu Zakona o državnoj službi br. 03 / L-149 i Uredbi o procedurama zapošljavanja u državnoj službi Republike Kosovo br. 02/2011, Univerzitet "Ukshin Hoti" OBJAVLJUJE:

### KONKURS

#### 1. Kancelarija za međunarodnu saradnju

<b>Radno mjesto</b>	<b>Upravnik za međunarodnu saradnju PBS/170</b>
<b>Pozicija</b>	<b>Profesionalna</b>
<b>Trajanje</b>	<b>Bez ograničenja</b>
<b>Broj pozicija</b>	<b>1</b>
<b>Kategorija</b>	<b>Upravni nivo</b>
<b>Nivo</b>	<b>6</b>
<b>Koeficijent</b>	<b>UNI 31</b>
<b>Probni rad</b>	<b>Bez probnog rada</b>
<b>Radno vrijeme</b>	<b>Puna norma (40 sati nedeljno)</b>

**Nadzornik:** Generalni sekretar univerziteta

- Osigurava sprovođenje strateškog plana UUHP-a za internacionalizaciju univerziteta, kao i pruža potrebnu profesionalnu podršku menadžmentu za sprovođenje ovog plana 20%.
- Daje profesionalne savete i preporuke menadžmentu univerziteta u svojstvu rukovodioca kancelarije i pomaže u izradi i izvršenju međunarodnih sporazuma 15%.
- Upravlja kancelarijskim radom tako što komunicira sa institucijama sa kojima UUHP ima sporazume o međunarodnoj saradnji i brine se o sprovođenju, ažuriranju i proširenju ovih sporazuma 15%.
- U koordinaciji sa Uredom za informisanje vodi računa o verziji zvanične veb stranice na engleskom jeziku i celoj zvaničnoj univerzitetskoj dokumentaciji tako što kontinuirano promovise univerzitet na međunarodnom nivou od 15%.
- Pruža svu potrebnu podršku u saradnji sa odgovarajućim kancelarijama UUHP; projektna kancelarija, kancelarija za mobilnost studenata i osoblja i druga slična kancelarija 10%.
- Organizuje sastanke rektora i menadžmenta Univerziteta UUHP međunarodnog karaktera, kao i pomoć u organizovanju međunarodnih naučnih konferencija unutar i izvan univerziteta.
- Obezbeđuje uz pomoć podređenog osoblja i usmeno i pismeno prevođenje na zvanične jezike Republike Kosovo, po potrebi i potrebe univerziteta, 10%.
- Omogućuje redovnu evaluaciju osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuke kako bi se osiguralo da se njihove dužnosti izvršavaju u skladu sa traženim standardima; Obavlja druge slične poslove kako to zahteva rukovodstvo i univerzitet 5%.

#### Potrebne veštine:

- Uslovi: univerzitetska diploma, politologija, pravni fakultet ili strani jezik, najmanje 5 godina radnog iskustva; napredno znanje engleskog jezika.
- Odlične veštine upravljanja, organizacije, postavljanja ciljeva i planiranja;
- Dobro poznavanje efikasnog nadzora nad profesionalnim radom koji obavljaju podređeni;
- Visok nivo komunikacionih i pregovaračkih veština na engleskom jeziku;
- Fleksibilnost organizovanja i nadzora rada, uključujući rešavanje problema;
- Veštine softverskih aplikacija (Word, Excel, Pover Point, Internet).

#### Dokumenti:

- Obrazac za prijavu
- Diplome i drugi dokazi (ovjerene kopije kod notara),
- Dokaz o radu (profesionalni i menadžerski),
- CV (biografija)
- Izvod iz knjige rođenih,
- Lična karta - fotokopija,
- Potvrda (dokaz da niste pod istragom).

#### OPŠTE INFORMACIJE:

Konkurs je otvoren samo za službenike Univerziteta "Ukshin Hoti".

Konkurs ostaje otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počev od 18.02.2020. Do 26.02.2020 u 15:00 časova, koji se smatra posljednjim danom zatvaranja konkursa.

Aplikacije dostavljene nakon roka neće biti prihvaćene

Državni službenici se primaju na osnovu zasluga propisanih Zakonom o civilnoj službi Republike Kosovo br. 03 / L-149 i Uredbe o procedurama regrutacije u civilnoj službi br. 02/2010.

Pravo da budu zaposleni u državnoj službi imaju građani Republike Kosova koji imaju potpunu poslovnu sposobnost, imaju potrebnu edukativnu pripremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje poslova potrebnih za relevantnu poziciju.

Univerzitet pruža jednake mogućnosti za sve u smislu člana 16, stav 2 Uredbe br. 02/2010. Zapošljavanje i izbor će se vršiti u skladu sa Zakonom o državnoj službi Republike Kosovo br. 03 / L-149 i Uredbom o procedurama zapošljavanja u državnoj službi br. 02/2010.

Kosovska državna služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice imaju pravo na fer i proporcionalnu zastupljenost u organima državne službe centralne i lokalne javne administracije kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona 9 o civilnoj službi Republike Kosovo br. 03 / L-14.

Zahtjev (aplikacija) za zapošljavanje može se uzeti u prostorijama Univerziteta ili skinuti sa sajta (web): www.uni-prizren.com, koji je objavljen konkuresit i isti se podnese, zajedno sa potrebnom dokumentacijom u Kancelariji 526 na adresi: Rr. "Shkronjat" br. 1, 20000 Prizren, svakog radnog dana od 10:00 do 15:00.

Prijave primljene nakon isteka roka biće primljene ako datum na poštanskoj isporuci, ili bilo koji drugi dokaz o datumu otpreme, ukazuje na to da je poslat prije isteka roka za podnošenje prijava.

Samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.





**Njoftim për Anulimin e Shpalljes publike**

Divizioni i Burimeve Njerëzore ne KEK. sha njofton te gjithë aplikuesit se anulohet pozita : Inxhinier te elektroteknikes ( 6 kryerës) pika 7 e Shpalljes publike me nr. 8975 e datës 21.09.2019 e publikuar ne gazetën ditore Epoka

Nga pjesëmarrësit ne konkurs kërkohjmë mirëkuptim



**Shpallje Publike**

Sipas nevojave të paraqitura për angazhimin e punëmarrësitë për punë specifike në Divizionin e Financiar, bazuar në Ligjin e punës neni 10 pika 2, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 14.02.2020 publikon vendin e lire për pozitën e më poshtme:

**Konsulentit për Menaxhimin e Projektit (Për punë specifike në kohëzgjatje për 4 muaj)**

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Këshillon menaxherin e kontratës për ERP në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Ndhimor në rishikimin e progresit të zbatimit të ERP. Konsulenti për menaxhimin e projektit së bashku me Menaxherin e Projektit do të rishikojë planin e projektit sa i përket orarit dhe targeteve të implementimit dhe do të sigurojë informata periodike rreth statusit të realizimit të projektit për Menaxhimin e KEK-ut. Merr pjesë aktive në takimet e rishikimit të statusit të projektit me personat përgjegjës të caktuar nga KEK-u në ekipin e menaxhimit të projektit dhe divizionet zbatuese në nivele të ndryshme të korporatës, propozon zgjidhjen e çështjeve në pritje. Konsulenti për menaxhimin e projektit do të identifikojë dhe raportojë çështje që kërkojnë vëmendje të Menaxhimit të KEK-ut. Konsulenti për menaxhimin e projektit do të ndihmojë KEK-un në zgjidhjen e lehtë të çështjeve. Përgjegjës për zhvillimin e një marrëdhënie të mirë me kompaninë përkatëse të zbatimit, merr inputet e kërkuara nga KEK-u dhe bashkë me PM i komunikon me kompaninë zbatuese. Parashikon faktorët e rrezikut dhe ndihmoni KEK-un që ta eliminojë atë për përfundimin me sukses të projektit. Konsulenti do të gjurmtojë dhe rishikojë të gjitha furnizimet e Kompanisë Implementuese dhe do të japë informata kthyesë Menaxhimit të KEK-ut. Konsulenti do të konfirmojë cilësinë dhe njafueshmërinë e furnizimeve, sipas kontratës me kompaninë zbatuese. Në fund të periudhës së angazhimit duhet të bëjë një raport përmblidhës të procesit të implementimit të ERP si dhe proceset e ndërlidhura mbetura për tu përditësuar në Korporate. Raporti mund të dorëzohet edhe pas përfundimit të periudhës së angazhimit pas datës së përfundimit të projektit. Po ashtu kryen edhe punë të tjera, të ndërlidhura me implementimin e ERP.

**Kohëzgjatja e shërbimeve:**  
Ofruesi i shërbimeve të konsulencës pritet të angazhohet për gjithsej 120 ditë pune nga periudha e nënshkrimit të kontratës. Megjithatë për çfarëdo kërkesë që lidhet me shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe, konsulenti do të ofrojë shërbime shtesë nën përgjegjësinë e tij edhe pas kësaj periudhe.

**Edukimi minimal, dhe ekspertiza e kërkuar:** Të jetë i diplomuar në Sistemet e Informacionit Kompjuterik ose Financë ose një fushë të lidhur ngushtë me fushëveprimin e këtij angazhimi, (master do të ishte përparësi)  
Të jetë i licencuar si auditor Ligjor dhe/ose njohës i proceseve financiare. Përvoja apo titulli IT Audit do të ishte përparësi. Të ketë njohuri nga parimet e menaxhimit të projektit. Minimum pesë vjet përvojë të përgjegjësisë në një mjedis të teknologjisë së informacionit, përvojë me raportime dhe aplikime analitike nga këndvështrimi i mbështetjes teknike (mbështetja e aplikacionit, përkufizimet e objekteve, mbështetja e përdoruesit fundor, etj.). Përvojë minimale 5 vjeçare në sistemin ERP dhe menaxhimin e aplikimeve me fokus në ndarjet financiare. Gjithashtu të ketë njohuri të shkëlqyeshme të proceseve ndër-funksionale të biznesit të një sistemi ERP. Të ketë përvojë në analizën e biznesit dhe procesit, si dhe analiza të rrjedhës së punës.  
Të ketë përvojë në të kuptuarit dhe përkthimin e koncepteve teknike tek informacioni dhe audiencia jo-teknike.  
Njohuri të mira të bazave të të dhënave të mëdha si MS SQL dhe / ose Oracle, menaxhimi me këto të dhëna është përparësi.  
Njohuri të rrjedhshëm të gjuhës angleze. Të ketë aftësi të punës në grup si dhe të ketë aftësi komunikuese, dhe shkathtësi në raportim.

**Si të aplikohet:** Për hollësitë e mëtutjeshme për pozitën e lartpërmendura shikoni në faqen e internetit të KEK-ut [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com). Aplikacionin të cilin e gjeni në faqen tone te internetit. te dërgohen ne adrese: [ofertapune@kek-energy.com](mailto:ofertapune@kek-energy.com).

Prishtinë, 14.02.2020  
Data e aplikimit deri 28.02.2020



**Sqarim për lexuesit e gazetës “Epoka e re”**

Gazeta “Epoka e re” me datë 14.02.2020, ka pranuar nga KEK-u, një kërkesë për shpalljen dhe publikimin e një konkursi për vend të lirë të punës me titull:

**Konsulentit për Menaxhimin e Projektit (për punë specifike në kohëzgjatje për 4 muaj).**

I njëjti konkurs është dashtë të botohet me datë 15 shkurt 2020 por për shkaqe teknike ky konkurs nuk është botuar faqe në faqet e gazetës sonë. Prandaj i njëjti konkurs pa ndërhyrje botohet me datë 19.02.2020. I kërkohjmë falje KEK-ut, dhe të interesuarve për aplikim në këtë konkurs. Me respekt departamenti i marketingut “Epoka e re”.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009**

► Valdete Zeneli Brahimi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, Banka dhe Financa në UP.

► Brahim Musaj B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 601552913

► Burim Llutaj shpall te pavlefshme certifikatën e furrtarit 30.01.2018 instituti Dituria Prizren.

► Zecir Murati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën certifikatën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

► Murat Kadriaj shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.

► Artan Mazrek shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Brigada 125" Medvec.

► Arian Gavazaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Dëshmoret e Zhurit" Zhur.

► Elif Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Emin Duraku" Prizren.

► Fadil Buqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Emin Duraku" Prizren.

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë ) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.**





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

